



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në:

“Financë Bankë”

Universiteti Bujqësor i Tiranës

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Prof. Dr. Gentiana Sharku

Prof. Asoc. Dr. Etleva Bajrami

Korrik / 2023

TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**Master Profesional në "Financë Bankë"**

1	IAL aplikues:	Universiteti Bujqësor i Tiranës
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Financë Kontabilitetit
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master Profesional në "Financë Bankë"
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASR Nr. 676 datë 12.10.2018
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	-
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	-
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	Dy vite akademike / 4 semestra
10	Kreditet në total (ECTS):	120 kredite (ECTS)
11	Forma e studimit:	Me kohë të plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Gjuha shqipe
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7 (shtatë)
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	16 PAE / 3 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022: 44 studentë 2022-2023: 30 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në "Financë Bankë", është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Nr. 676 datë 12.10.2018. Ky program ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, i Universitetit Bujqësor të Tiranës.

Institucioni i Arsimit të Lartë, publik, " Universiteti Bujqësor i Tiranës (UBT) është themeluar në vitin 1951 si Instituti i Lartë Bujqësor në bazë të VKM Nr.548, date 28.07.1951, ndërsa në vitin 1991 është ndryshuar emërtimi në "Universiteti Bujqësor i Tiranës".

Universiteti Bujqësor i Tiranës ka kryer procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit institucional të zhvilluar nga ASCAL. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 59, datë 16.12.2021 "Për akreditimin periodik të institucionit të arsimit të Lartë Universiteti Bujqësor i Tiranës", me kohëzgjatje 5 vite akademike, me afat vlefshmërie deri më 15.12.2026.

Universiteti Bujqësor i Tiranës është i organizuar në përputhje me përcaktimet e Ligjit nr.80/2015 në gjashtë njësi kryesore:

- Fakulteti Bujqësisë dhe i Mjedisit;
- Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit;
- Fakulteti i Bioteknologjisë dhe Ushqimit;
- Fakulteti i Shkencave Pyjore;
- Fakulteti i Mjeksisë Veterinare;
- Instituti i Resurseve Gjenetike të Bimëve.

Programi i studimit Master Profesional në "Financë Bankë" ofrohet nga Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit (FEA), që përbëhet nga 6 njësi bazë, një ndër të cilët është Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit i i cili është njësi bazë përgjegjëse që mbulon programin e studimit Master Profesional në "Financë Bankë".

Programi i studimit Master Profesional në "Financë Bankë", është emërtuar dhe organizuar në përputhje me fushat dhe drejtimet akademike të njësisë kryesore të institucionit të arsimit të lartë, në fushën financë-bankë. Ky program studimi është i organizuar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi, VKM Nr. 41, datë 24.01.2018 "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL", sipas të cilit lëndët ndahen në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore / integruese, lëndë plotësuese dhe detyrime përmbyllëse. Programi i studimit realizohet me 120 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale dy vite akademike (katër semestra), në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë të ciklit të dytë të studimeve "Master Profesional në Financë Bankë". Objektivi kryesor i këtij programi është formimi i ekspertëve dhe specialistëve në aspektet teorike, praktike dhe aplikative në fushën e financës si manaximi i ndërmarrjeve, të bankave dhe ndërmjetësve financiarë.

PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Në datën 29.01.2022, Universiteti Bujqësor i Tiranës ka dorëzuar pranë ASCAL formularin e aplikimit për akreditimin për herë të parë të programit të studimit Master Profesional në "Financë Bankë". ASCAL bazuar në "Manualin për Procedurat dhe Afatet për Vlerësimin e Cilësisë në kuadër të Akreditimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe programeve të studimit 2017" ka përzgjedhur dy vlerësues të jashtëm për të shqyrtuar dokumentacionin e përcjellë nga Universiteti Bujqësor i Tiranës, për të kryer vizitën në institucion dhe për të përpiluar raportin e vlerësimit të jashtëm. Grupi i vlerësimit të jashtëm ka në përbërje Prof. Dr. Gentiana Sharku, pedagoge ne FEUT, Departamenti i Financës, dhe Prof. Asoc. Dr. Etleva Bajrami, pedagoge FEUT, Departamenti i Financës. Gjatë të gjithë fazës së vlerësimit të jashtëm ky grup pune u asistua dhe nga menaxherja teknike e ASCAL, Msc. Majlinda Demirneli.

Në datën 30.01.2023, ekspertëve të jashtëm iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i dorëzuar nga institucioni për vlerësim. Pas një kohe në dispozicion të ekspertëve për të studiuar dokumentat dhe për të përpiluar pyetjet apo paqartësitë e tyre, u përcaktua edhe agjenda e vizitës në institucion, e cila u zhvillua në datat 30 dhe 31 Mars 2023 në ambjentet e Universitetit Bujqësor të Tiranës. Gjatë vizitave ekspertëve iu vendos në dispozicion një sallë mbledhjesh për të kryer të gjitha takimet sipas agjendës së planifikuar. Dokumentacioni shtesë i kërkuar nga ekspertët u vu në dispozicion në datën 18.04.2023.

Pas rishikimit të dokumentacionit të institucionit dhe intervistave me pyetje të përcaktuara të ekspertëve, GVJ paraqet si më poshtë vlerësimin e tij sipas standarteve dhe për çdo kriter që i referohet standartit për programin e studimit Master Profesional në "Financë Bankë".

Në fund paraqiten rekomandimet për programin e studimit dhe kryhet një analizë SËOT mbi programin e studimit që riakreditohet. Ky raport është përpiluar në bashkëpunim midis dy ekspertëve të jashtëm dhe paraqet mendimet e tyre të integruara.

Universiteti Bujqësor i Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 14.07.2023, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 38/29 Prot, datë 14.07.2023. Universiteti Bujqësor i Tiranës më datë 19.07.2023, me anë të shkresës me Nr.512/2 Prot, datë 19.07.2023 "Dërgohen komentet mbi Draft Raportin", ku shprehin dakortësinë me vlerësimin e kryer nga Ekspertët e Jashtëm. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master Profesional në “Financë Bankë”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës ofron programe studimi në përputhje me interesat kombëtare. UBT i themeluar që prej vitit 1951 ka respektuar dhe ruajtur interesat kombëtare. Universiteti Bujqësor i Tiranës operon duke respektuar ligjin e arsimit të lartë. Kjo reflektohet në Statutin e Universitetit, Rregulloren e Universitetit si dhe në programin e studimit Master Profesional në Financë Bankë, të cilët respektojnë ligjin e arsimit të lartë. Programi i studimit është një program bashkëkohor që ruan vlerat akademike dhe kulturore kombëtare. Në Statutin e UBT është e shprehur se veprimtaria e institucionit bazohet në Kushtetutën e Shqipërisë dhe Ligjin Nr 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”.</p> <p>Në vizionin afatgjatë, të përcaktuar në Statutin e Universitetit, synimi i Universitetit Bujqësor të Tiranës është të jetë qendra ekselente më e madhe e edukimit universitar, kërkimit dhe trajnimit për përgatitjen profesionale të specialistëve të fushës së bujqësisë, në drejtim të zhvillimit të bujqësisë moderne dhe garantimit të ushqimit të shëndetshëm dhe cilësor.</p> <p><i>Evidence 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Evidence 1.3 Rregullore e Studimeve Universitare</i> <i>Evidence 1.5 Rregullore e programit të ciklit të dytë të studimeve MPFB</i></p>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit. Misioni dhe qëllimet e institucionit të përcaktuara në Statutin e Institucionit, si krijimi, transmetimi, zhvillimi, dhe mbrojtja e dijes duke formuar specialistë të lartë, të ndihmojë pozitivisht në nivel kombëtar, janë të reflektuara në programin e Master Profesional në Financë Bankë.</p> <p>Sikurse është e shprehur në Statut, UBT ka si mision të ndikojë pozitivisht në cilësinë e jetës në nivel kombëtar dhe më gjerë, ti</p>

	<p>ofrojë mundësi shoqërisë të përfitojë nga arsimi i lartë në fushat e tij të ekspertizës. Veprimtaria e institucionit është mësimdhënia, kërkimi shkencor, transferimi i njohurive, etj., dhe është në bazë të hartimit të programit të studimit Master Profesional në Financë Bankë.</p> <p>Ndër fushat e veprimtarisë të përmendura në Planin Strategjik të menaxhimit të UBT-së (2016-2025) janë agromjedisi dhe mbrojtja e tij, ekonomia agrare, ekonomia bujqësore, menaxhimi i ndërmarrjeve, financë dhe kontabilitet, marketing, etj. Fusha e veprimtarisë së programit të studimit Master Profesional “Financë Bankë” është financa dhe banka të cilat janë në përputhje me fushat e veprimtarisë së institucionit.</p> <p><i>Evidencë 1.2 Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf</i> <i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.</p>	<p>Programi i studimit është në përshtatje dhe në zbatim të Planit Strategjik të menaxhimit të UBT-së (2016-2025) (pika 1.1), Statutit (Neni 3) dhe Rregullores së Institucionit (Kreu III, pika 16, për format e cikleve të studimit) për përgatitjen e shkencëtarëve dhe specialistëve të rinj në fushat e ekonomisë, menaxhimit të ndërmarrjeve, mjedisit, bujqësisë, etj.</p> <p>Në Strategjinë e UBT përcaktohet se me anë të ndërthurjes së edukimit me kërkimin shkencor, UBT kërkon të përgatisë jo vetëm specialisë të kualifikuar të fushës së bujqësisë, ushqimit dhe mjedisit por edhe qytetarë të përgjegjshëm në shërbim të shoqërisë. Programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës dhe zhvillimit ekonomik.</p> <p><i>Evidencë 1.2 Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf</i> <i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Evidencë 1.3 Rregullore e Studimeve Universitare</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.</p>	<p>Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit. Zhvillimi ekonomik i vendit është në përputhje me përgatitjen e specialistëve të nivelit Master të cilët do të ndihmojnë në zhvillimin e bizneseve. Bizneset vendase duhet të drejtohen drejt tregjeve ndërkombëtare dhe të zhvillohen dhe operojnë si bizneseve ndërkombëtare. Ndërkohë që programi i studimit është hartuar në mënyrë të tillë që të jepet kontribut në drejtimin Financë Bankë. Sistemi arsimor në Shqipëri është diversifikuar sikurse theksohet në Planin Strategjik të</p>

	<p>menaxhimit të UBT (2016-2025) dhe institucioni ofron programe studimi konkurruese në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar. Në Rregulloren e programit të studimit si qëllim është pajisja e studentëve me njohuri në nivel të krahasueshëm me diplomat që lëshojnë strukturat analoge universitare jashtë vendit (Rregullorja e programit të studimit, Neni 3).</p> <p>Programi i studimit MPFB është një program bashkëkohor me interes kombëtar dhe në përputhje me prirjet globale të zhvillimit në lidhje me kërkesat për specialistë në financë dhe bankë.</p> <p><i>Evidencë 1.2 Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Universiteti Bujqësor i Tiranës ofron programe studimi bashkëkohore që ruajnë vlerat akademike dhe kulturore në përputhje me interesat kombëtare.</i> - <i>Programi i studimit është hartuar në përputhje me qëllimin dhe misionin e institucionit si krijimi, transmetimi, zhvillimi, mbrojtja e dijes, etj.</i> - <i>Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe është në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, Statutit dhe Rregullores së Institucionit.</i> 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Plot	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2	
Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për	<p>Programi i studimit MPFB ofrohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit.</p> <p>Referuar RVB-së, Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit operon me këtë strukturë që prej vitit 2007. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka një përvojë të gjatë në fushën akademike dhe</p>

<p>ofrimin e një programi studimi në atë fushë.</p>	<p>ka përvojë, kapacitete dhe burimet e duhura për ofrimin e këtij programi.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit i krijuar në vitin 1971, u ristrukturua në vitet 93-2000, duke iu përshtatur ndryshimeve ekonomike-sociale të kohës. Fushat e veprimtarisë, drejtimet akademike, misioni, objektivat, etj, tregojnë për një përvojë dhe kompetencë të lartë në fushën akademike.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit përbëhet nga gjashtë departamente, njëri prej të cilëve është Departamenti i Financë Kontabilitetit.</p> <p>Departamenti i Financë Kontabilitetit përbëhet nga 17 pedagogë, staf akademik i brendshëm me experiencë profesionale dhe kryesisht me grada dhe tituj dhe nga 19 pedagogë, staf akademik me kontratë.</p> <p><i>Evidencë 1.2 Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf</i> <i>Evidencë nr. 3.4 CV</i></p>
<p>Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.</p>	<p>Fushat e përgjithshme dhe specifike e programit janë në përputhje me fushën akademike të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, profili Financë Banke është pjesë përbërëse në fushën e studimit të ekonomisë.</p> <p>Fushat e veprimtarisë të përmendura në Planin Strategjik të Menaxhimit të UBT-së (2016-2025) mbulojnë disa drejtime të ekonomisë si agromjedisi dhe mbrojtja e tij, ekonomia agrare, ekonomia bujqësore, menaxhimi i ndërmarrjeve, financë dhe kontabilitet, marketing, etj, dhe fusha e përgjithshme dhe specifike është në përputhje me fushat akademike të institucionit.</p> <p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka në përbërje 6 departamente.</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Drejtim Agrobiznesit; ▪ Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural; ▪ Departamenti i Financë- Kontabilitetit; ▪ Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural; ▪ Departamenti i Matematikës dhe Informatikës; ▪ Departamenti i Gjuhëve të Huaja; <p>Fushat kryesore të studimit jepen në Statutin e UBT dhe secili department është në përputhje me fushat e studimeve akademike të përcaktuara në statut. Programi i studimit MPFB ofrohet nga</p>

	<p>Departamenti i Financë Kontabilitetit dhe është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore.</p> <p><i>Evidencë 1. 1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA</i></p>
<p>Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Financë Bankë ofrohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit i cili ofron edhe program Bachelor në Financë Kontabilitet duke pasur në qendër të punës akademike dhe kërkimore fushën e financës dhe ekonomisë në përgjithësi.</p> <p>Masteri Profesional në Financë Bankë ju jep mundësinë studentëve që duan të thellojnë studimet në fushën e financës dhe bankës të vazhdojnë studimet dhe kërkimet shkencore.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Çkilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA</i></p>
<p>Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohehet nga institucionet partnere.</p>	<p>GVJ konkludon se Programi i studimit Master Profesional në Financë Bankë është brenda profilit të Institucionit.</p>
<p>Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional në Financë Bankë është hapur në vitin akademik 2018-2019, dhe për studentët që kanë ndjekur këtë program studimi, institucioni nuk ka ofruar trajtime profesionale të mëtejshme. Gjatë vizitës në institucion u diskutua nga stafi që aplikimi për kurs (trajnim) profesional është realizuar. Në evidencat e institucionit gjendet edhe Propozimi për kurs trajnimi për Financat për Vendimarrje.</p> <p><i>3.8 Propozim kurs trajnimi për Financat për Vendimarrje.PDF</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni ka kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike me staf akademik të brendshëm dhe me kontratë me experiencë dhe kryesisht me grada dhe tituj. - Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit është në përputhje me fushën akademike të Institucionit dhe të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit.

	- Program i studimit Masteri Profesional në Financë Bankë ju jep mundësinë studentëve që duan të thellojnë studimet në fushën e financës dhe bankës të vazhdojnë studimet dhe kërkimet shkencore.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës siguron marrëdhënie bashkëpunimi efçente ndërmjet njësive kryesore dhe njësive bazë, duke ndarë detyrat në mënyrë të qartë. Ndarja e detyrave krijon mundësinë për të përcaktuar përgjegjësitë dhe për të analizuar rezultatet e punës së çdo njësie. Statuti i Universitetit (Kreu II, Neni 5) ka të përcaktuar ndarjen në njësi kryesore, njësi bazë, degët dhe njësitë ndihmëse ku përcaktohen qartë funksionet e secilës njësi.</p> <p>Në Rregulloren e Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit (<i>Kreu I, Neni 6</i>) përcaktohen të detajuara përgjegjësitë e Njësive bazë.</p> <p>Është përgjegjësi e njësisë bazë të propozojë programet e studimit. Njësia kryesore harton politikat dhe procedurat për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Institucioni kryen çdo fund viti analizën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore dhe njëkohësisht analizon edhe ecurinë e marrëdhënieve me publikun dhe institucionet. Kjo analizë bëhet sipas departamenteve dhe programeve të studimit për të tre ciklet e studimit. Në këtë analizë jepen edhe rekomandimet e nevojshme sipas rastit.</p> <p>Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë ndjek të gjitha problemet që kanë lidhje me procesin mësimor.</p> <p>Në Rregulloren e FEA përcaktohet se drejtuesi i Departamentit informohet nga personeli akademik rreth veprimtarisë që ata</p>

	<p>kryejnë dhe kryen kontroll të veprimtarisë. Rregullorja e Programit të studimit detajon të gjithë procedurat duke përcaktuar edhe përgjegjësitë.</p> <p><i>Evidencë. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA</i> <i>Evidencë 2.3 Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore UBT 2019-2020.pdf</i> <i>Evidencë 2.4 Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore, FEA, 2019-2020.pdf</i> <i>Evidencë 2.5. Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Institucionet 2021-2022 .pdf</i> <i>Evidencë. 6.4 Format Pyetësi për Vlerësimin e Procesit Mësimor.pdf</i></p>															
<p>Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.</p>	<p>Universiteti Bujqësor i Tiranës ka një numër marrëveshesh bashkëpunimi me institucione homologe vendase dhe të huaja si dhe me institucione të tjera publike dhe private për të realizuar objektivat studimore si në procesin e mësimin ashtu edhe në realizimin e praktikave mësimore. Në dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni është edhe Raporti mbi nivelin e bashkëpunimit institucional të UBT brenda dhe jashtë vendit ku është dhënë një analizë ku informacioni në lidhje me marrëveshjet është dhënë në mënyrë sasiore.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.17 Raport i Bashkëpunimit Institucional të UBT brenda dhe jashtë vendit, 2022</i> <i>Evidencë nr. 1.22 Lista e marrëveshjeve 2022</i></p>															
<p>Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, dhe kompani të ndryshme për realizimin e praktikave profesionale. Në këtë drejtim institucioni zhvillon edhe Panairin e karrierës si një mundësi për forcim të marrëveshjeve dhe krijim të marrëveshjeve të reja, nëpërmjet të cilave një pjesë e studentëve zhvillojnë praktikat profesionale. Zhvillimi i praktikave profesionale krijon mundësi për punësim pranë institucioneve dhe bizneseve me të cilat janë lidhur marrëveshjet.</p> <p>Në evidencat e paraqitura marrëveshjet janë të shumta si me institucionet ashtu edhe me universitetet e huaja dhe shqipfolëse.</p> <table border="1" data-bbox="550 1585 1369 1892"> <thead> <tr> <th>Partneret</th> <th>Numri total i marreveshjeve</th> <th>Marrëveshje gjatë vitit 2022</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>Bashki</td> <td>1</td> <td>1</td> </tr> <tr> <td>Universitete te huaja</td> <td>64</td> <td>4</td> </tr> <tr> <td>Universitete shqipfolëse</td> <td>27</td> <td>7</td> </tr> <tr> <td>Aktorë të tjerë (Ministri, agjensi, organizata, etj.)</td> <td>44</td> <td>9</td> </tr> </tbody> </table>	Partneret	Numri total i marreveshjeve	Marrëveshje gjatë vitit 2022	Bashki	1	1	Universitete te huaja	64	4	Universitete shqipfolëse	27	7	Aktorë të tjerë (Ministri, agjensi, organizata, etj.)	44	9
Partneret	Numri total i marreveshjeve	Marrëveshje gjatë vitit 2022														
Bashki	1	1														
Universitete te huaja	64	4														
Universitete shqipfolëse	27	7														
Aktorë të tjerë (Ministri, agjensi, organizata, etj.)	44	9														

	<p>Sipas RVB-së, FEA ka 62 marrëveshje bashkëpunimi nëpërmjet të cilave kryhen praktikat profesionale të studentëve. Në funksion të trajnimit të studentëve janë edhe marrëveshjet Erasmus+.</p> <p><i>Evidencë 1.17 Raport i Bashkëpunimit Institucional të UBT brenda dhe jashtë vendit, 2022.pdf</i> <i>Evidencë 1.22 Lista e marrëveshjeve 2022 .pdf</i> <i>Evidencë 2.8 Informacion, Zyra Erasmus, UBT.</i></p>
--	--

<p>Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni ka hartuar raporte në lidhje me gjurmimin e studentëve të UBT si një i tërë, ku analizohen përfitimet nga marrëveshjet, por nuk ka raport të veçantë në lidhje me gjurmimin e programit të studimit Master Profesional Financë Bankë. E njëjti konkluzion arrihet edhe nga Raporti i Panairit të Karrierës te 2022, kur është realizuar Panairi i katërt i karrierës, ku në raport përcaktohet se të dhënat janë për Bsc, MP dhe Msc.</p> <p><i>Evidencë 2.6.2 Raport i Gjurmimit të Studentëve në UBT 2021</i> <i>Evidencë 2.6.3 Raport i Panairit të Karrierës, qershor, 2022</i></p>
--	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni siguron marrëdhënie bashkëpunimi efçente ndërmjet njësive kryesore dhe njësive bazë, duke ndarë detyrat krijon mundësinë për të përcaktuar përgjegjësitë dhe për të analizuar rezultatet e punës së çdo njësie.</i> - <i>Institucioni ka një numër marrëveshjesh bashkëpunimi me institucione homologe vendase dhe të huaja si dhe me institucione të tjera publike dhe private për të realizuar objektivat studimore si në procesin e mësimit ashtu edhe në realizimin e praktikave mësimore.</i> - <i>Institucioni harton raporte në lidhje me gjurmimin e studentëve të UBT-së si një i tërë. Nuk ka raport të veçantë në lidhje me gjurmimin e programit të studimit Master Profesional Financë Bankë.</i>
---------------------------	--

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Përbushet plotësisht	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë të vlerësuara në kredite dhe janë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Programi i ciklit të dytë të studimit Master Profesional në “Financë Bankë”, është hapur me Urdhër të Ministrit të Arsimit, Nr. 676 datë 12.10.2018. Programi i studimit realizohet me një total prej 120 kredite (ECTS) në dy vite akademike me 25 orë për kredit.</p> <p><i>Në planin mësimor të programit të studimit, lëndët janë klasifikuar sipas veprimtarive formuese dhe janë të organizuara në 5 kategori, nga A në E, duke respektuar përqindjet e krediteve për çdo veprimtari sikurse përcaktohet në VKM nr. 41.</i></p> <p><i>Por GVJ konstaton se përmbajtja e lëndëve/moduleve nuk përputhet me kategorinë në të cilën janë përfshirë. Për shembull, si lëndë bazë janë vendosur lëndë ndërdisipinore apo plotësuese si “Shërbimet e sigurisë dhe konsulencës” dhe “Sistemet e Informacionit”.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon rikategorizimin e lëndëve/moduleve në planin mësimor, duke marrë në konsideratë përmbajtjen e tyre.</i></p> <p><i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB</i> <i>Evidencë 3.3.2.2 Plani mësimor i programit MPFB 2021-2022</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës,</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Financë Bankë” me anë të lëndëve të përfshira synon të jap njohuri të avancuara në fushën e financës dhe bankave, institucionet financiare, bankare dhe agrare. Programi i studimit sikurse u përmend më lart është në përputhje me Planin Strategjik të menaxhimit të UBT (2016-2025) në lidhje me drejtimit që mbulohen dhe me Statutin e Institucionit në lidhje me përgatitjen e specialistëve të rinj në fushat e ekonomisë, menaxhimit të ndërmarrjeve, mjedisit, bujqesisë, etj.</p>


<p>zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>Studentët që diplomohen në këtë program studimi përgatiten për tu punësuar në sferat menaxheriale financiare dhe bankare. Me anë të lëndëve specifike si Insitucionet dhe organizatat agrare, Sistemet e informacionit në drejtim, Shërbimet e sigurisë dhe konsulencës, programi i studimit i pajis studentët me njohuri dhe kompetenca të cilat do ti ndihmojnë jo vetëm në profesion por edhe në të kuptuarit kritik të teorive dhe situatave që do të jetë e nevojshme të analizojnë dhe drejtojnë. Lëndët e përfshira japin mundësi të realizimit të analizave të avancuara të problemeve të mundshme në fushën e studimit Financë Bankë.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Evidencë 1.2 Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.</p>	<p>Në Rregulloren e Brendshme të FEA si dhe në Programin e studimit Master Profesional “Financë Bankë” tregohen lëndët dhe kreditet përkatëse. Sikurse lëndët edhe praktika profesionale dhe detyrimet përmbyllëse mikroteze apo provim kanë kreditet përkatëse.</p> <p>VKM nr. 41, ndryshuar me VKM nr 879/2019 dhe VKM nr.185/2021 në Tabelën 1 kanë përcaktuar Elementët e programeve të studimit.</p> <p>Në kategorinë A bëjnë pjesë disiplina të formimit të përgjithshëm për përgatitje metodologjike dhe kulturë të përgjithshme duhet të ketë 5 – 10% të krediteve;</p> <p>Në kategorinë B, përfshihen disiplina të formimit karakterizues të programit për përgatitje shkencore dhe duhet të kenë 30 – 40% të krediteve;</p> <p>Në kategorinë C përfshihen lëndë ndërdisiplinore, profile dhe grup lëndësh me zgjedhje dhe duhet të kenë 20 – 30% të krediteve;</p> <p>Në kategorinë D përfshihen lëndët plotësuese si gjuhë të huaja, njohuri informatike dhe praktika profesionale dhe duhet të ketë 10% të krediteve totale në Master Profesional;</p> <p>Në kategorinë E janë detyrimet përmbyllëse për diplomim dhe duhet të ketë 10 – 20% të krediteve;</p> <p>Sipas planit mësimor, Praktika profesionale ka 20 ECTS dhe së bashku me Detyrimet përmbyllëse Mikroteze/ Provim final</p>

	<p>zhvillohen në semestrin e katërt. Detyrimet përmbyllëse Mikroteze/ Provim final, kanë 10 ECTS.</p> <p>Pesha që zë Praktika Profesionale në totalin e krediteve është 20 ECTS/120 ECTS =16.7%. Nëse shtojmë edhe kreditet e lëndës Sistemet e informacionit në drejtim që duhet të jetë pjesë e Kategorisë D, kjo peshë është edhe më e madhe.</p> <p><i>GVJ sygjeron që duhet të rishikohet si përmbajtja e lëndëve/moduleve në kategoritë përkatëse, ashtu edhe kreditet ECTS e Praktikës Profesionale.</i></p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA</i> <i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB</i></p>
<p>Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.</p>	<p>N/A</p>
<p>Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120 kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.</p>	<p>N/A</p>

<p>Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>Forma e organizimit të studimeve si dhe kriteret e pranimit të studentëve në Universitetin Bujqësor të Tiranës dhe veçanërisht në nivelin Master janë të mirëpërcaktuara. Universiteti Bujqësor i Tiranës operon në përputhje me Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015.</p> <p><i>Evidencë 2.10 Propozimi i Kritereve për Pranimin e Studentëve 2023-2024</i> <i>Evidencë 2.10.1 Propozimi i Kritereve për Pranimin e Studentëve 2022-2023</i> <i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB</i></p>
<p>Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.</p>	<p>RVB shprehet se në Universitetin Bujqësor të Tiranës nuk ka master tjetër të të njëjtës fushë. Programe të ngjashme masteri në fushën e financë bankës zhvillohen nga disa institucione të arsimit të lartë. Në Statutin e Institucionit është e përcaktuar se përmbajtja e atyre programeve të studimit të UBT-së që ofrohen edhe nga disa institucione të tjera të arsimit të lartë në të njëjtën fushë studimi, cikël dhe me të njëjtën emërtesë kanë ngjashmëri në nivel, së paku 70%. Programi i Masterit Profesional “Financë Bankë” është i ndërtuar me një numër të madh lëndësh (modulesh) dhe si rrjedhim ka ngjashmëri së paku 70 % me programe të ngjashme studimi të ciklit të dytë Master.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB</i></p>
<p>Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.</p>	<p>Në dokumentat e dorëzuara është vërtetimi nga QSHA me numrin unik të identifikimit. Programi i studimit ka kodin unik të identifikimit. Statuti i UBT shpjegon ciklet dhe programet e ofruara sipas Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve. Nuk ka informacion se lëndët janë të kodifikuara. Sipas RVB për këtë kriter, dhe verifikuar nga GVJ edhe në shkresën e ardhur nga MASR, kodi unik i programit të studimit është BU3437211085.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021</i> <i>Evidencë 4.4 Vërtetim Regjistrimi i Programit MPFB bazuar në Numrin Unik të Identifikimit.</i></p>
<p>Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në</p>	<p>Programi i studimit nuk ofrohet si program i përbashkët me institucion tjetër të arsimit të lartë. Masteri Profesional Finance Bankë ofrohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit të FAE, UBT.</p> <p><i>Evidencë 4.3 Urdhër 676 datë.10.10.2018 për Hapjen e Programit të Ciklit të dytë Studimeve MPFB.</i></p>

përputhje me legjislacionin në fuqi.									
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Elementët që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë vlerësuar në kredite në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</i> - <i>Ndarja e Planit mësimor sipas veprimtarive formuese nuk është plotësisht sipas legjislacionit vendas në fuqi.</i> - <i>Programi i studimit Master Profesional Financë Bankë me anë të lëndëve të përfshira përgatiten për tu punësuar dhe realizimit të analizave të avancuara të problemeve të mundshme në fushat e studimit të Financës dhe Bankës.</i> - <i>Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e detyrimeve përmbyllëse dhe praktikën profesionale, kreditet e së cilës nevojitet të rishihen.</i> 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përbushet pjesërisht</th> <th>Përbushet kryesisht</th> <th>Përbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>		Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht			X	
	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht						
		X							

Standardi II.2	
Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	<p>Njësia kryesore përgjegjëse për programin e studimit Master Profesional "Financë Bankë" është Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka në përbërje 6 departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Departamenti i Drejtim Agrobiznesit; ▪ Departamenti i Ekonomisë dhe Politikave të Zhvillimit Rural; ▪ Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit; ▪ Departamenti i Menaxhimit të Turizmit Rural; ▪ Departamenti i Matematikës dhe Informatikës; si dhe



▪ Departamenti i Gjuhëve të Huaja.

Njësia kryesore përmbush detyrimet duke respektuar Statutin dhe Rregulloret përkatëse për organizimin, strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.

Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit në vitin akademik 2022-2023 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (89 pedagogë PAE) dhe 71 Personel Akademik me Kontratë, të cilët kanë kualifikimin si më poshtë:

Kualifikimi i stafit	Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	13	4
Prof.Asoc	32	3
Dr/PhD	32	18
Dr në proc	11	1
Msc	1	45
Gjithsej	89	71

Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit si njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit në vitin akademik 2022-2023 ka këtë paraqitje:

Kualifikimi i stafit	Departamenti i Financës dhe Kontabilitetit	
	PAE	PAK
Prof.Dr	4	3
Prof.Asoc	5	1
Dr/PhD	7	5
Dr në proc	1	-
Msc	-	10
Gjithsej	17	19

Për realizimin e procesit mësimor janë të angazhuar edhe personel akademik me kontratë, PAK.

Cilësia e stafit mësimdhënës për prgramin e studimit MPFB (Marrë nga Aneks: Tabela 6)						
Titulli/Grada	2020-2021		2021-2022		2022-2023	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr	4	2	4	2	3	2
Prof.Asoc.	5	-	6	-	8	-
Dr	8	1	6	1	5	1
Msc	-	-	-	-	-	-
Gjithsej	17	3	16	3	16	3


	<p>Per vitin akademik 2021-2022 sipas RVB 87% e ngarkesës mësimore është realizuar nga pedagogë PAE dhe 13% e e ngarkesës mësimore është realizuar nga pedagogë PAK.</p> <p><i>Evidencë 3.3.2. Plani mësimor i programit MPFB</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Bankë</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.</p>	<p>Stafi ndihmës akademik është pjesë e rëndësishme e mbarëvajtjes së aktiviteteve të procesit mësimor, ndihmon për realizimin e praktikave mësimore, proceset laboratorike, etj. Departamenti Financë Kontabilitet ka 1 (një) personel ndihmës akademik.</p> <p>Nga RVB njësia kryesore FEA ka të punësuar 8 punonjës staf ndihmës akademik.</p> <p><i>Evidencë 3.4.1 Cv e Stafit Ndhimes akademik. PDF.PDF</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>
<p>Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.</p>	<p>Në Statutin e UBT-së Neni 22, parashikohet Kordinatori i Programit të Studimeve, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së tij.</p> <p>Në rregulloren e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional në “Financë Bankë” është e përcaktuar se Koordinator i Programit të studimit është Përgjegjësi i Grupit Mësimor Kërkimor i Financës. Sipas RVB-së Kordinatori ndjek realizimin e programit mësimor, monitoron mbarëvajtjen e zhvillimit të mësimimit dhe angazhohet dhe kujdeset në ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021</i> <i>Evidencë. Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.</i> - <i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për mbarëvajtjen e aktiviteteve të procesit mësimor, praktikat mësimore apo proceset laboratorike.</i> - <i>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit ka koordinator programi i cili është përgjegjës për</i>

	<i>realizimin e programit mësimor, monitorimin e mbarëvajtjes së zhvillimit të mësimit dhe angazhohet dhe kujdeset në ruajtjen e cilësisë së mësimdhënies.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmishet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3	
Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit, UBT dhe Departamenti Financë Kontabilitet, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. Dokumentacioni i depozituar është i nevojshëm dhe i plotë për të organizuar programin e studimit.</p> <p>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit disponon Rregulloren e Universitetit, Rregulloren e brendshme të Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Rregulloren e studimit të ciklit të dytë, Master Profesional Financë Bankë, Kurrikulën e Programit të studimeve, Planin mësimor, etj.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimeve MPFB. pdf</i> <i>Evidencë 3.3.1 Kurrikula e programit MPFB 2022-2023.pdf</i> <i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse.pdf</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p>	<p>Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.</p> <p>Rregullorja e programit të studimit MPFB (Neni 4), përcakton se studimet në MP realizohen me 120 kredite dhe organizohen në kohë të plotë me kohëzgjatje normale 2 vite dhe 4 semestra. Çdo vit akademik ka 2 semestra ku secili semestër ka 15 javë.</p>

	<p>Plani mësimor i Programit të studimit përmban 18 lëndë (disiplina) ku 3 prej të cilave janë me zgjedhje. Plani mësimor përmban informacionin në lidhje me orët që zhvillohen brenda dhe jashtë auditorit si dhe detyrimet për çdo lëndë. Çdo kredit vlerësohet 25 orë, ku në çdo vit realizohen 1500 orë në total, nga të cilat në vitin e parë 720 orë realizohen në auditor, ndërsa në vitin e dytë realizohen 360 ore në auditor.</p> <p>Në planin mësimor përcaktohen kreditet ECTS për çdo lëndë, si dhe për praktikën profesionale dhe mikrotezën.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Bankë.PDF</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit Master Profesional “Financë Bankë” jepet informacioni i nevojshëm për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Këto kriteret janë të parashikuara edhe në Statutin e UBT dhe Rregulloren e UBT për Studimet Universitare.</p> <p>Sipas <i>Neni 9</i> të Rregullores së Programit të studimit ku jepen kriteret e pranimit në këtë program studimi kanë të drejtë të aplikojnë individët që kanë përfunduar një program studimi dhe kanë fituar diplomë universitare “Bachelor”.</p> <p>Kriteret specifike janë kriteri i meritës dhe i rëndësisë. Përzgjedhja e kandidatëve fitues do të jetë rezultat i produktit që del nga prodhimi i notës mesatare në bachelor me koeficientin e profilit të studimeve bachelor. Në këtë mënyrë hartohet lista e kandidatëve, dhe shpallen fitues të renditurit brenda kuotave.</p> <p>Në programin e studimit MPFB kanë të drejtë të transferohen shtetas shqiptarë ose të huaj sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe rregulloreve të UBT, FEA dhe të programit të studimit. Sipas Rregullores së programit të studimit (<i>Neni 41</i>), transferimet lejohen brenda të njëjtit cikël studimi e në fusha të njëjta ose të përafërta dhe vetëm në fillim të vitit akademik. Vendimi për njohjen e plotë ose të pjesshme të krediteve të fituara nga një student që transferohet në hyrje i takon komisionit të posaçëm të ngritur nga FEA.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit (<i>Neni 42</i>), DFK ofron mundësi për transferime të ndërmjetme midis programeve të të njëjtit cikël, brenda vetë institucionit apo institucioneve të</p>

	<p>ndryshme të arsimit të lartë, si dhe lejon largimin e studentëve të tij për në universitete të tjera sipas procedurave të përshkruara në nenet vijuese të rregullores.</p> <p>Për studentët që kërkojnë të transferojnë studimet apo kërkojnë të vazhdojnë një program të dytë studimi të njëjtë apo të ngjashëm DFK bën të mundur ekuivalentimin e një pjesë, programeve të plota ose diplomave të marra në institucione të tjera të vendit ose të huaja sipas përcaktimeve të Statutit të UBT (<i>Neni 44</i>).</p> <p>Pranë FEA dhe me urdhër të Dekanit të Fakultetit ngrihen komisionet <i>ad hoc</i> të njohjes dhe ekuivalentimit të studimeve. Komisionet përbëhen nga tre anëtarë: Zv dekani për mësimin dhe kurrikulat i cili është edhe kryetar i komisionit, përgjegjësi i departamentit dhe përgjegjësi i grupit mësimor, kjo në varësi të programit që kërkohet të ekuivalentohet. Rregullat e ekuivalentimit përshkruhen me hollësi në Rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>Programi i studimit Master Profesional “Financë Bankë” përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset). Programi i studimit jep informacion në lidhje me kreditet dhe orët që zhvillohen në leksione dhe seminare, brenda dhe jashtë auditorit si dhe detyrimet për çdo modul. Çdo lëndë ka 5 ECTS dhe 60 orë në auditor. Gjithashtu Programi i studimit përcakton edhe orët jashtë auditorit.</p> <p>Syllabuset e lëndëve japin informacionin në lidhje me formën e kontrollit të dijeve dhe mbi frekuentimin. Në <i>Nenin 54</i> të Rregullores së brendshme të FEA përcaktohet se plani mësimor i një program studimi përbën dokumentacionin me karakter të gjerë informativ dhe në të jepen:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Emërtimi i moduleve - Numri i krediteve për çdo modul - Detyrimet sipas moduleve (seminare, detyra kursi, projekt kursi, provim) - Periudha dhe mënyra e kontrollit (provim me gojë apo e shkrim) <p>Në programin mësimor të modulit (syllabusit) jepet në formë të përmbledhur struktura e syllabusit, <i>Neni 55</i> i Rregullores së brendshme të FEA. Në programin mësimor të modulit</p>




	<p>(syllabusit) jepet informacion mbi lektorin/lektorët që do të zhvillojnë modulin, kursin dhe semestrin kur zhvillohet, peshën e ECTS, objektivat e modulit, etj.</p> <p>Format e mësimi teorik e praktik janë: leksionet, seminarët, ushtrimet, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat e kursit, projektet e kursit, etj. Në syllabuse jepet informacion për përqindjen që zënë në vlerësim seminarët, punët praktike, detyra e kontrollit, detyra e kursit dhe orët e laboratorit, si dhe mënyrën e vlerësimit. Në Rregulloren e brendshme të FEA jepet sistemi i vlerësimit dhe format e vlerësimit (i vazhdueshëm dhe përfundimtar) dhe format e kontrollit të dijeve (<i>Neni 63-65 i Rregullores së brendshme të FEA</i>).</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse.pdf</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>
<p>Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.</p>	<p>Në RVB theksohet rishikimi i programeve të lëndëve me qëllim përditësimi i tyre. Një gjë e tillë u konfirmua edhe gjatë vizitës zyrtare pranë institucionit nga stafi akademik. Në Rregulloren e FEA, <i>Neni 20</i> lë të hapur mundësinë për rishikim të përmbajtjes së programit të studimit. Modulet mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në programet e studimeve dhe kreditet për secilën prej tyre mund të rishikohen. Ndryshimet propozohen nga departamenti përkatës duke ndjekur instancat deri në miratimin përfundimtar nga Senati Akademik i UBT në rastin kur masat e ndryshimit të kërkuar nuk kalojnë nivelin 20%.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon rregullore, planin e studimit, kurrikulën, syllabuset, etj për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.</i> - <i>Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</i> - <i>Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për, seminarët, detyrat e kursit, projektet e kursit, provimi apo</i>





	<i>orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përkrahje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.</p>	<p>Emërtimi i lëndëve është në përputhje me brendësinë e temave dhe qëllimin. Përmbajtja dhe shpërndarja e lëndëve është e tillë që mundëson kompetenca të studentit duke formuar profesionistë dhe mundësuar punësimin e tyre.</p> <p>Ky program studimi synon thellimin e njohurive në drejtim të Financës dhe Bankave dhe aktivitetit të tyre dhe përmbajtja e lëndëve është në funksion të këtij synimi. Lëndët janë kategorizuar sipas tipit të veprimtarisë si lëndë bazë, lëndë karakterizuese, lëndë ndërdisiplinore, lëndë plotësuese dhe detyrimet përmbyllëse. Njohuritë e marra në këtë master mundësojnë studime të mëtejshme.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>
<p>Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor.</p>	<p>Lëndët janë të shpërndara në katër semestra gjithsej, ku në semestrin e katërt zhvillohet Praktika profesionale dhe Mikroteza/Provimi formimi final.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion nga diskutimet me stafin akademik të angazhuar në mësimdhënie në këtë master dhe studentët na u komunikua se mësimi zhvillohet në dy ditë, të premtën dhe të shtunën për tju përshtatur kërkesave të studentëve.</p> <p>Në <i>Nenin 19</i> të Rregullores së FEA, përcaktohet se objektivat e programeve të studimit për formimin e studentëve janë ofrimi dijes, aftësive, kompetencat profesionale dhe analitike. Lëndët e MPFB mundësojnë arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit dhe kërkimit shkencor. Programi mësimor ka një numër relativisht të madh</p>

	<p>lëndësh, 18 lëndë. Lëndët kanë secila 5 ECTS, me një total 90 kredite. Praktika profesionale dhe Mikroteza kanë respektivisht nga 10 dhe 20 ECTS.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>									
<p>Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit “Master Profesional”, ky program duhet të sigurojë aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional.</p>	<p>Lëndët që janë në përbërje të programit të studimit janë lëndë të cilat gjenden në përbërje të programeve të ngjashme mësimore si kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p>Programi i studimit përcakton orët që zhvillohen në auditor, jashtë auditorit si dhe orët e praktikës profesionale. Struktura e programit përmban informacionin në lidhje me orët që zhvillohen brenda dhe jashtë auditorit. Çdo vit realizohen 1500 orë në total, nga të cilat në vitin e parë 720 orë realizohen në auditor, ndërsa në vitin e dytë realizohen 360 orë në auditor. Së bashku me praktikën profesionale dhe mikrotezën, respektivisht 500 dhe 250 orë, gjithsej rezultojnë 1830 orë.</p> <p>Leksionet përfaqësojnë teorinë, megjithatë ndërthurja teori-praktikë ndodh në çdo veprimtari të mësimdhënies. Në vijim jepen të detajuara pa përfshirë mikrotezën/ provimin e formimit;</p> <table border="0" data-bbox="590 1030 1228 1176"> <tr> <td>▪ Leksione</td> <td>180*3 semestra=</td> <td>540 orë</td> </tr> <tr> <td>▪ Seminare</td> <td>180*3 semestra=</td> <td>540 orë</td> </tr> <tr> <td>▪ Praktikë profesionale</td> <td></td> <td>500 orë</td> </tr> </table> <p>Totali 1'580 orë</p> <p>Raporti Teori/ Praktikë është rreth 34% / 66% (540 orë leksione / 1040 orë seminar dhe praktikë).</p> <p>Gjykojmë se ky raport, lëndët dhe përmbajtja e tyre janë të përafërta me programe të ngjashme ndërkombëtare.</p> <p>Kjo strukturë është në përputhje me profilin dhe objektivat e programit të studimit dhe siguron mundësinë e njohurive të thelluara profesionale.</p> <p><i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>	▪ Leksione	180*3 semestra=	540 orë	▪ Seminare	180*3 semestra=	540 orë	▪ Praktikë profesionale		500 orë
▪ Leksione	180*3 semestra=	540 orë								
▪ Seminare	180*3 semestra=	540 orë								
▪ Praktikë profesionale		500 orë								
<p>Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues,</p>	<p>Lëndët që janë në përbërje të programit të studimit janë të mjaftueshme, dhe mundësojnë arritjen e objektivave formuese, transferimin e studimeve si dhe mobilitetet. Lëndët mundësojnë kompletim të kompetencave në financë bankë për të mundësuar punësim në përfundim të studimeve.</p>									



<p>transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.</p>	<p>Ndërsa përsa i përket ndarjes sipas veprimtarisë formuese mëndojmë se mund të ishte strukturuar më saktë në lidhje me lëndët bazë, plotësuese dhe ndërdisiplinore. GVJ është shprehur për këtë tek Standardi II.1, Kriteri 3.</p> <p><i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>
<p>Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p>	<p>Sikurse përmendet në RVB por edhe gjatë vizitës zyrtare dhe takimit me stafin, përditësimi i Syllabuseve bëhet në mënyrë të vazhdueshme, si për tju përshtatur tregut po ashtu edhe literaturave më të fundit të fushës së studimit.</p> <p>Sikurse jemi shprehur më herët <i>Neni 20</i> i Rregullores së FEA, parashikon mundësinë për rishikim të përmbajtjes së programit të studimit. Modulet mësimore dhe veprimtaritë formuese që ofrohen në programet e studimeve dhe kreditet për secilën prej tyre mund të rishikohen. Në vizitën në institucion gjatë takimit me studentët na u komunikua se merret mendimi tyre në lidhje me syllabuset. Ky mendim tërhiqet gjatë diskutimeve dhe prej plotësimit të pyetësorëve në lidhje me cilësinë e mësimdhënies në fund të procesit mësimor. Pedagogët janë gjithashtu iniciator të përditësimit të syllabuseve që ata vet zhvillojnë duke përfshirë në to literaturat bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë 6.4 Format Pyetësori për Vlerësimin e Procesit Mësimor.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit Master Profesional Finance Bankë, lëndët dhe ndërtimi i syllabuseve garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p>GVJ konstaton se lëndët dhe përmbajtja e tyre kompleton njohuritë e një specialisti në financë dhe bankë. Kështu lëndët si Financa Personale, Vlerësim i ndërmarrjeve, Drejtim financiar, Financë ndërkombëtare kompletojnë njohuritë dhe kompetencat në financë. Lëndët si Teknika bankare, Mbikqyrja e institucioneve financiare, Drejtimi i institucioneve financiare ofrojnë njohuri në fushën bankare dhe institucioneve financiare. Lënda Drejtim portofoli kompleton kompetencat si financiare ashtu edhe bankare duke ofruar njohuri mbi diversifikimin e investimeve. Njohuritë thellohen me lëndët e profilit të kontabilitetit si dhe E drejta financiare dhe bankare. GVJ vlerëson se me lëndët në përbërje të programit të studimit, mënyra e zhvillimit të programit dhe kërkimit të vlerësimit të njohurive ky</p>

	<p>program studimi garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.</p> <p><i>Evidencë 3.3.1 Kurrikula e programit MPFB 2022-2023.pdf</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse.pdf</i></p>								
<p>Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>Përmbajtja e programit të studimit është e ndërtuar me lëndë të cilat mundësojnë njohuri të përditësuara në fushën e financës dhe bankës të cilat mundësojnë vijimin e mëtejshëm të studimeve.</p> <p>Në Kriterin 6 kemi përmendur lëndët kryesore të cilat janë garantueset e kompetencave dhe të punësimit të studentëve.</p> <p>Emërtimi i programit është bashkëkohor pasi mbulon fushat e financës bankës të cilat janë komplementare për të nxjerrë specialistë. Emërtimi dhe përmbajtja e lëndëve thëllon njohuritë e përfituara në bachelor dhe mundëson punësim të studentëve sepse përputhen me kërkesat e tregut të punës në fushën e financës dhe bankës.</p> <p><i>Evidencë 3.3.1 Kurrikula e programit MPFB 2022-2023.pdf</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse.pdf</i></p>								
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Emërtimi i lëndëve është në përputhje me brendësinë e temave dhe qëllimin për thellimin e njohurive në drejtim të Financës dhe Bankave.</i> - <i>Programi i studimit siguron aftësi, kompetenca dhe formim të thelluar profesional. Lëndët janë të shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit.</i> - <i>Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës. Përmbajtja e programit të studimit mundëson njohuri të përditësuara në fushën e financës dhe bankës.</i> 								
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td style="text-align: center;">X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.</p>	<p>Në RVB është shprehur se për tju përshtatur kërkesave të punës, FEA dhe DFK janë të angazhuar në përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit.</p> <p>Sipas RVB-së në fillim të çdo viti stafi akademik dorëzon në form elektronike dhe hardcopy programin e lëndës ku ka reflektuar përmirësimet e nevojshme bazuar në zhvillimet në tregun e punës, apo nga eksepriencia të fituara gjatë kualifikimeve. Në këtë drejtim janë të rëndësishme edhe leksionet e hapura me ekspertë të fushës, ku pas konferencave shkencore, tryezave të rrumbullakta konsultimesh, stafi akademik reflekton përmirësimet në program. Institucioni ka lidhur marrëveshje me një sërë institucionesh publike dhe private. Nga këto marrëveshje mundësohet zhvillimi i praktikave profesionale si dhe synohet punësimi i studentëve. Në mënyrë që programi i studimit ti përgjigjet kërkesave të tregut tërhiqen mendimet e partnerëve, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. Për këtë një mundësi shumë e mirë është edhe panairi i punës që zhvillon UBT.</p> <p><i>Evidencë 1.17 Raport i Bashkëpunimit Institucional të UBT brenda dhe jashtë vendit, 2022.pdf</i> <i>Evidencë 2.17 Trajnimet e Stafit të Brendshëm 2015-2021, FEA.pdf</i> <i>Evidencë 3.1 Propozimi për Riorganizimin e Programit të Studimit MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 3.2 Studim Tregut pune FB.PDF</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.</p>	<p>Institucioni tërheq mendimet e studentëve në fund të semestrave në lidhje me lëndët dhe aspekte të mësimin me anë të një pyetësori anonim, ku studentët shprehin opinionin e tyre.</p> <p>Studentët janë të përfshirë në disa organe të institucionit si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, Këshilli i Studentëve, NJSBC, Komisionin e Sigurimit të Cilësisë dhe Komisionit për programet e studimit dhe kërkimin shkencor, dhe në këto struktura tërhiqet mendimi i drejtpërdrejtë i tyre. Institucioni mban lidhje të vazhdueshme me studentët e diplomuar, prej të cilëve merr informacion në lidhje me punësimin e tyre, kërkesat e tregut të punës duke mundësuar edhe të kuptuarit e nevojës për ndryshim të programit.</p>

	<p><i>Evidencë 1.16 Manuali cilësisë UBT.pdf</i> <i>Evidencë 01. RVB_MPFB.pdf</i> <i>Vizita në institucion</i></p>			
<p>Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.</p>	<p>Drejtuesi dhe stafi i FAE dhe DFK për zhvillimin eficient të procesit mësimor përmirëson kurrikulat duke ju përshtatur ndryshimeve më të fundit dhe të vazhdueshme. Përmirësimi i programit të studimit nuk është vetëm qëllim në vetvete por edhe domosdoshmëri për të qenë kompetitiv në fushën e arsimit të lartë. Për përmirësimin e programit të studimit angazhohen drejtuesit, stafi akademik dhe studentët nëpërmjet mekanizmave të përshkruara edhe në kritere të mëparshme. Po në këtë drejtim shërbejnë marrëveshjet me institucione të tjera publike dhe private, profesionistë që ftohen të japin leksione. Merren mendimet e studentëve aktuale dhe të diplomuar të cilët janë bërë pjesë e stafit apo janë tashmë profesionistë në tregun e punës.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit, duke nxitur diskutime si dhe marrëveshjet me institucione të tjera publike dhe private, profesionistë që ftohen të japin leksione, etj.</i> - <i>Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, tërheq mendimet e studentëve në fund të semestrave në lidhje me lëndët dhe aspekte të mësimi.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në</p>	<p>Në rregulloren e MPFB përcaktohen misioni dhe objektivat e programit të studimit. Programi i studimit është i ndërtuar në përputhje me nevojat e tregut dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Objektivat kryesore janë formimi i studentëve me dije, aftësi dhe kompetenca profesionale dhe analitike që duhet të fitojnë studentët në përfundim të tij.</p>

<p>përputhje me objektivat madhorë të institucionit.</p>	<p>Formimi i studentëve realizohet nëpërmjet njohurive të nevojshme që janë të përfshira në lëndët që janë në përbërje të programit të studimit të cilat janë në një linjë me objektivat. Këto objektiva janë në përputhje me misionin dhe objektivat madhore të UBT-së të shprehura në Statutin e Institucionit, <i>Neni 3</i>.</p> <p><i>Evidencë 1. 1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.</p>	<p>Në rregulloren e FEA (<i>Neni 6</i>), është e përcaktuar se me anë të Departamenteve realizohet bashkërendimi, zhvillimi dhe administrimi i aktiviteteve të mësimdhënies. Në Statutin e UBT, <i>Neni 6</i> përcakton njësinë kryesore si bashkërendues të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Liria akademike e personelit akademik garantohet në <i>Nenin 2</i> të Statutit të UBT.</p> <p>DFK nëpërmjet rregullores ka të përcaktuar mënyrën se si bashkërendon dhe administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik të garantuar në statutin e UBT.</p> <p><i>Evidencë 1. 1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.</p>	<p>Studentët janë të motivuar për të marrë pjesë në projekte dhe aktivitete kërkimore shkencore. RVB shprehet për përfshirjen e studentëve në konferencë shkencore të organizuar nga fakulteti, gjë që u pohua prej studentëve dhe stafit akademik gjatë takimit. Sipas RVB-së studentët janë përfshirë në konferencë me bashkëpunime me pedagogët. Nxitja dhe motivimi i angazhimit të studentëve në studime dhe projekte kryhet si pjesë integrale e formimit të studentëve në drejtimin e synuar sepse të gjitha lëndët një nga format e kontrollit të dijeve është përgatitja e një detyre kursi.</p> <p><i>Evidencë 01. RVB_MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron</p>	<p>Sipas RVB prej vitit akademik 2021-2022 është parashikuar fond i veçantë për aktivitetet kërkimore dhe shkencore. Stafi akademik nxitet të botojë në revista me faktorë impakti dhe scopus duke ju mbuluar kostot e botimit. Vitin e fundit akademik institucioni ka miratuar procedurat dhe ka njoftuar stafin akademik për mundësinë e mbështetjes financiare për punimet e realizuara dhe të botuara në revista të vlerësuara me faktor impakti.</p>

të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	<p>Gjatë vizitës stafi u shpreh se nxiten të botojnë në revista pa pagesë me faktorë impakti dhe scopus. Mbështetje financiare konkrete është bërë për pedagogët e rinj. Pedagogët efektiv të cilët janë rregjistruar një vit më parë në programin e ciklit të tretë të studimit janë përjashtuar nga pagesa e tarifës së studimit.</p> <p><i>Evidencë 01. RVB_MPFb.pdf</i> <i>Evidencë 6.1 Relacion për Realizimin e Buxhetit për vitin 2021 dhe Planifikimi për vitin 2022.pdf</i></p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Programi i studimit përcakton qartë në rregullore prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit. - Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore, për financimin e të cilave njësisia bazë mbështetet financiarisht nga institucioni. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbyhet	Përmbyhet pjesërisht	Përmbyhet kryesisht	Përmbyhet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.</p>	<p>UBT ka miratuar Rregullore mbi hartimin dhe menaxhimin e projekteve në UBT. Në këtë rregullore është e shprehur se UBT nxit dhe krijon kushtet për pjesëmarrje të stafit akademik dhe kërkimor në projekte të ndryshme. UBT ofron pëdorimin e infrastrukturës laboratorike nga stafi që janë pjesë e projekteve.</p> <p>Përgjegjësit e njësive bazë sigurohen që drejtuesit e projekteve të kenë kompetencën e nevojshme. Po në këtë rregullore përcaktohet procedura e hartimit, aplikimit dhe miratimit të projektit dhe bashkëpunimi i nevojshëm me strukturat e tjera kërkimore. Në RVB gjejmë që gjatë 3 viteve të fundit numri i projekteve kërkimore të fituara nga FEA është 4, dhe janë angazhuar 49 pedagogë të fakultetit nga të cilët 20 pedagogë japin</p>

	<p>mësim në këtë program studimi. Pjesëmarrja në projekte vendase dhe ndërkombëtare ndër vite e stafit akademik u konfirmua edhe prej tyre gjatë vizitës në institucion.</p> <p><i>Evidencë 1.9 Rregullore mbi Hatimin dhe Menaxhimin e Projekteve të UBT, 2021</i></p> <p><i>Evidencë 2.16 Pjesëmarrja e Stafit në Projekte brenda dhe jashtë vendit (2015-2021).pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.</p>	<p>UBT nxit personelin akademik dhe kërkimor që të aplikojnë në projekte dhe studime të ndryshme. UBT ofron përdorimin e infrastruktures për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe nxit personelin akademik dhe studentët për pjesëmarrje.</p> <p>UBT ka si mision të vet të krijojë, transmetojë, të zhvillojë e të mbrojë dijet nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor, etj. Si rrjedhim institucioni është i gatshëm tju përgjigjet nevojave të personelit akademik për studime dhe projekte me karakter shkencor. Në tabelën 18 të RVB-së jepet numri i botimeve nga personeli akademik efektiv të DFB përgjegjës për programin e studimit dhe janë 60 botime të kryera prej tyre. Numri i pjesëmarrësve si partner në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare në nivel Fakulteti janë 20. Sikurse është shprehur në Standartin II.6 kriteri 3, institucioni nxit pjesëmarrjen edhe të studentëve në aktivitete dhe projekte shkencore. Në drejtim të angazhimit dhe nxitjes janë të rëndësishme edhe marrëveshjet e bashkëpunimit që UBT krijon me institucione dhe organizma të tjera brenda dhe jashtë vendit.</p> <p><i>Evidencë 01. RVB_MPFb.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 1.2.1 Plani Strategjik i Kërkimit 2016-2025, UBT.pdf</i></p> <p><i>Evidencë 2.16 Pjesëmarrja e Stafit në Projekte brenda dhe jashtë vendit (2015-2021).pdf</i></p> <p><i>Evidencë 6.8 Model Projekti i Studentëve "YSSA Tirana".pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.</p>	<p>UBT si dhe FEA organizojnë konferenca shkencore dhe workshope ku marrin pjesë me referime stafi akademik dhe kërkimor. Edhe studentët janë bërë pjesë e aktiviteteve shkencore që janë zhvilluar në bashkëpunim me institute të tjera të arsimit të lartë. Konferenca e IV-të studentore e Fakultetit Ekonomik të Kolegjit Universitar "Logos" u zhvillua në partneritet me Departamentin e Financë - Kontabilitet, të FEA dhe studentët morën pjesë me punime të realizuara në bashkëpunim me pedagogët.</p> <p><i>Evidencë 6.6 Konferenca UBT. ICOALSIII</i></p>

	<i>Evidencë 6.7 Konferenca studentore e organizuar nga Universiteti Logos me DFK</i>
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	<p>Programi i studimit Master Profesional në Financë Bankë me anë të lëndëve mundëson formimin e profesionistëve konkurrues për tregun e punës vendas dhe ndërkombëtar.</p> <p>Ky program studimi me anë të disiplinave që përfshin, me anë të metodologjisë së ndjekur, nxitjes së pjesëmarrjes së studentëve në konferenca dhe projekte përgatit profesionistë në tregun e punës. Programi i studimit formon dhe përgatit drejtues financiar dhe analistë financiar të bizneseve të sektorëve të ndryshëm të ekonomisë. Me anë të lëndëve që zhvillohen përgatiten analistë dhe raportues financiar. Programi i studimit përgatit analistë dhe këshillues bankar, specialist për shoqëritë financiare, kompanitë e sigurimeve dhe fondeve të pensioneve.</p> <p>Gama e lëndëve i jep mundësi studentit që të fitojë njohuri të nevojshme mbi administrimin fiskal, auditimin, financës rurale etj, duke formuar profesionistë si në bizneset prodhuese, tregtare, shërbimi financiar, etj., ashtu edhe në agroturizëm, zhvillimin rural, etj. Sipas Raportit të gjurmimit të studentëve të UBT, niveli i punësimit të studentëve të këtij institucioni është i kënaqshëm.</p> <p><i>Evidencë 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë 2.6.2 Raport i Gjurmimit të Studentëve në UBT 2021 .pdf</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i></p>
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	<p>Programi i studimit zhvillohet në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, dhe udhëzimet në fuqi.</p> <p>Ky program studimi është program bashkëkohor dhe formon profesionistë për të cilët ka nevojë tregu. Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione dhe organizma të ndryshme rrisin mundësinë për krijimin e kompetencave të nevojshme. Gjatë panairit të punës tërhiqen mendimet e institucioneve private dhe publike dhe e profesionistëve me të cilat UBT ka marrëveshje. Në funksion të rritjes së kompetencave është realizuar edhe riorganizimi i këtij programi studimi.</p> <p><i>Evidencë 1.2.1 Plani Strategjik i Kërkimit 2016-2025, UBT.pdf</i> <i>Evidencë 3.1 Propozimi për Riorganizimin e Programit të Studimit MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 3.2 Studim Tregut pune FB.PDF</i></p>
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me	N/A

aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. *Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU*).

Konkluzione

GVJ konstaton se:

- Njësia përgjegjëse mbështet grupet e lëndëve dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore si dhe ofron pëdorimin e infrastrukturës për realizimin e objektivave të projekteve.
- Institucioni organizon konferenca shkencore dhe workshope ku marrin pjesë me referime stafi akademik dhe kërkimor. Institucioni nxit përfshirjen e studentëve në konferenca shkencore.
- Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.

Shkalla e përmbushjes së standardit

	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II

	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT


Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënësve dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikatat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/ esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>Lëndët e Programit të studimit MPFB zhvillohen nëpërmjet formave tradicionale të mësimdhënies. Format tradicionale të mësimdhënies janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit, etj. Format e kontrollit të njohurive janë pjesëmarrja aktive, detyrat e kursit, testimet gjatë vitit dhe provimi përfundimtar. Në drejtim të zhvillimit të njohurive zhvillohen edhe leksione të hapura me profesionistë të ftuar.</p> <p>Format e mësimdhënies dhe mësimnxënies për këtë program studimi janë të strukturuar si vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ Leksione 180*3 semestra= 540 orë ▪ Seminare 180*3 semestra= 540 orë ▪ Praktikë profesionale 500 orë ▪ Diploma/Provimi Formimi 250 orë <p style="text-align: right;">Totali 1'830 orë</p> <p><i>Evidencë 3.3.1 Kurrikula e programit MPFB 2022-2023.pdf</i> <i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse.pdf</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.</p>	<p>Zhvillimi i kohëve të fundit drejt përdorimit të teknologjisë në çdo drejtim të zhvillimit ekonomik e ka përfshirë edhe botën akademike. Metodat e zhvillimit të mësimdhënies janë bërë më të larmishme dhe personeli akademik pranë MPFB zhvillon mësimin me mjete audio vizive dhe me mjete të kompjuterizuara nëse është e miratuar në program.</p> <p>Format e mësimdhënies janë të parashikuara në rregulloren e programit të studimit dhe të FEA. Nga vizita në institucion dhe veçanërisht nga takimi me studentët GVJ konstatoi se personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve nëpërmjet metodave të zhvillimit të orëve të mësimin.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i> <i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe</p>	<p>UBT dhe FEA kanë ngritur laboratorët e nevojshëm me mjete të kompjuterizuara me softwarë-t e nevojshëm për zhvillimin e lëndëve të programit të studimeve si Kontabiliteti financiar i avancuar, Ekonometri, etj.</p>

<p>në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ vëzhgoi ambientet laboratorike të cilat ishin funksionale dhe në përdorim aktiv gjatë orëve të mësimit. Institucioni trajnon stafin në mënyrë të vazhdueshme me anë të leksioneve të hapura me profesionistë dhe shkëmbim mobilitetesh. Edhe pjesëmarrja në projekte rrit profesionalisht stafin akademik.</p> <p><i>Evidencë nr. 0.1 RVB_MPFb.pdf</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësime në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimit interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë.</p> <p>Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.</p>	<p>Personeli akademik i angazhuar në mësime në programin e studimit është i përbërë nga pedagogë me tituj dhe grada. Pedagogët janë kompetent në ofrimin dhe shpjegimin e njohurive të nevojshme në fushat e financës dhe bankës.</p> <p>Mësimi zhvillohet me metoda që nxisin interaktivitetin e studentëve dhe mendimin krijues dhe kritik. Në këtë drejtim ndihmon edhe infrastruktura bashkëkohore që është në dispozicion të zhvillimit të mësimit.</p> <p><i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 3.4 CV.pdf</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimit në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.</p>	<p>Në Statutin e UBT-së (<i>Neni 9</i>), përcaktohet se përgjegjëse për programet mësimore është departamenti si njësia bazë e mësimit. Planet mësimore zhvillohen mbi bazën e kurrikulave. Sipas <i>Nenit 54</i> të Rregullores së FEA plani mësimor hartohet nga përgjegjësi i njësive bazë dhe miratohet nga Dekani FEA dhe Rektori i UBT-së.</p> <p>DFK si njësia bazë pranë të cilit zhvillohet programi i studimit MPFB mbikëqyr zhvillimin dhe diskuton mbi lëndët dhe mënyrat e zhvillimit. Në fund të semestrave tërhiqet mendimi i studentëve në lidhje me aspektet e zhvillimit të mësimit nëpërmjet pyetësorit. UBT tërheq mendimet e studentëve edhe nëpërmjet strukturave si Senati Akademik, Këshilli i Etikës, etj ku studentët marrin pjesë.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017</i></p>

<p>Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.</p>	<p><i>Evidencë 6.4 Format Pyetësori për Vlerësimin e Procesit Mësimor.pdf</i></p> <p>Sigurimi i cilësisë sigurohet nga struktura në nivel rektorati si Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë (DVBS) (Statuti i UBT, <i>Neni 83</i>) dhe Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të Studimit dhe Kërkimit Shkencor (Statuti i UBT, <i>Neni 18</i>). Pranë njërive kryesore janë ngritur Njësitë e Sigurimit të Cilësisë. NJSC mbulon çdo program studimi dhe kërkim shkencor të realizuar nga njësi kryesore.</p> <p>Në bashkëpunim me Dekanatin e njësisë kryesore harton planin vjetor të veprimit për përmirësimin e cilësisë dhe harton raportin vjetor të cilësisë (statute i UBT, <i>Neni 83, 85</i>).</p> <p>Këto struktura janë përgjegjëse për vlerësimin dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Këto struktura bashkërendojnë me njësitë bazë, për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Përgjegjësi i njësisë bazë dhe Kordinatori i programit të studimit mbështesin zhvillimin e cilësisë dhe përdorimin e metodave të reja të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë 1.1 Statuti i UBT</i> <i>Evidencë 1.7 Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm të Cilësisë</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Në programin e studimit format e mësimdhënies, mësimnxënies janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, dhe praktikat profesionale.</i> - <i>Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve në realizimin e programit duke zhvilluar mësimin me mjete audio vizive dhe me mjete të kompjuterizuara nëse është e miratuar në program.</i> - <i>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit është kompetent në ofrimin dhe shpjegimin e njohurive të nevojshme në fushat e financës dhe bankës.</i> - <i>UBT ka procedurë të qarta të fokusimit të të gjitha strukturave drejt cilësisë.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<table border="1"> <tr> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet pjesërisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</td> <td style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		



Standardi III.2

Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>Në Rregulloren e UBT (<i>Neni 57</i>), Rregulloren e brendshme të FEA (<i>Neni 64</i>) dhe Rregulloren e Studimit të Ciklit të dytë, Master Profesional Financë Bankë, jepen sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve, dhe ju bëhen të njohura studentëve.</p> <p>Studenti vihet në dijeni në fillim të semestrit për kriteret dhe mënyrat e vlerësimit. Vlerësimi përfundimtar i studentit është një rezultante e vlerësimit gjatë semestrit, detyrave dhe projekteve të kursit si edhe vlerësimi gjatë testimeve të lëndës. Provimet përfundimtare janë me shkrim kurse detyrat dhe projektet e kursit prezantohen.</p> <p><i>Evidencë 1.3 Rregullore e Studimeve Universitare</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>Rregullorja e Programit të studimit MPFB përcakton që në fillim të çdo viti akademik studentët të informohen për programin e studimit, strukturën mësimore, me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve. Gjatë vizitës në institucion studentët pohuan se e marrin informacionin në lidhje me metodologjinë e testimit e vlerësimit në fillim të zhvillimit të lëndës në semestrin përkatës.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ciklit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të</p>	<p>Programi i studimit të MPFB përcakton format e vlerësimit. Vlerësimi gjatë vitit përfaqëson 30 deri në 50% të vlerësimit total (Rregullore e UBT, <i>Neni 64</i>). Pjesa tjetër e vlerësimit përfaqësohet nga provimi përfundimtar. Pedagogët e lëndës përcaktojnë ndarjen e vlerësimit të vazhdueshëm gjatë vitit dhe përfundimtar. Format e kontrollit të dijeve nëpërmjet aktivizimeve në seminare, testimeve të ndërmjetme, detyrave të</p>

demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	<p>kursit dhe provimit përfundimtar i japin mundësi studentit të demonstrojnë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p> <p>Sipas tabelës së përfshirë në dokumentacionin e dorëzuar, format e kontrollit të njohurive sipas peshës që zënë në vlerësim janë si më poshtë:</p> <table border="0"> <tr> <td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj.)</td> <td>10%</td> </tr> <tr> <td>Testimet gjatë vitit</td> <td>20%</td> </tr> <tr> <td>Provimi përfundimtar</td> <td>60%</td> </tr> </table> <p>Studenti njihet në fillim të semestrit edhe me kushtet, nëse ka, që duhet të plotësojë që të hyj në provim.</p> <p><i>Evidencë 1.3 Rregullore e Studimeve Universitare</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i></p>				Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%	Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj.)	10%	Testimet gjatë vitit	20%	Provimi përfundimtar	60%
Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive	10%											
Plotësimi i detyrimeve (detyra kursi, etj.)	10%											
Testimet gjatë vitit	20%											
Provimi përfundimtar	60%											
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në Rregulloren e Institucionit, njësisë kryesore dhe të programit jepen sistemi i vlerësimit, format e vlerësimit dhe format e kontrollit të dijeve, dhe njihen nga studentët. - Vlerësimi përfundimtar i studentit është një rezultante e vlerësimit gjatë semestrit, detyrave dhe projekteve të kursit si edhe vlerësimit gjatë testimeve të lëndës. - Në fillim të çdo viti akademik studentët informohen për me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve. 											
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht								
				X								

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimit.

Kriteret

Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe

Rregullorja e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional, në Financë Bankë përcakton mënyrën e vlerësimit

<p>aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>të njohurive. Vlerësimi i njohurive ndahet në vlerësim gjatë vitit dhe vlerësimin përfundimtar.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve jepet informacion më i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm, i cili kryhet nëpërmjet aktivizimit të seminar, ushtrimeve, detyrave të kontrollit dhe detyrave të kursit. Pikët e vlerësimit të vazhdueshëm nuk janë pengesë për hyrjen e studentit në provim por mbliidhen me pikët e vlerësimeve të tjera për percaktimin e notës finale.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>Sikurse gjendet në RVB, UBT ka vendosur në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit. Per korrigjimin e provimeve institucioni ka vënë në zbatim sistemin e korrigjimit të automatizur “Clean Score” i cili jo vetëm ofron transparencë por edhe shpejtësi në marrjen e rezultateve, gjë që u konfirmua edhe nga stafi i angazhuar në këtë program studimi. Ndërkohë gjatë pandemisë u krijuan kushtet për zhvillimin e provimeve online.</p> <p><i>Evidencë 0.1 RVB_MPFb.pdf</i> <i>Evidencë 6.2.1 Clean Score.pdf.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.</p>	<p>Mënyra e vlerësimit përfundimtar përcaktohet në Rregulloren e programit të studimit. Vlerësimi përfundimtar bëhet pas zhvillimit të provimit final i cili mund të jetë me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Pikëve të vlerësimit final i shtohen pikët e fituara gjatë vlerësimit të vazhdueshëm për të përcaktuar vlerësimin përfundimtar. Syllabusi i çdo lënde është i ndërtuar në mënyrë që të jepet informacion i detajuar për mënyrën e vlerësimit të vazhdueshëm, i cili kryhet nëpërmjet aktivizimit të seminar, detyrave të kontrollit, detyrave të kursit, projekteve të kursit dhe provimit final.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse</i></p>
<p>Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar</p>	<p>Pas vlerësimit të njohurive notat hidhen në sistem dhe studenti njihet me vlerësimin nëpërmjet sistemit. Nëse studenti ka pakënaqësi apo paqartësi në lidhje me vlerësimin studenti ka të drejtë të bëjë kërkesë për të ballafaquar përgjigjet në provim me tezën e zgjidhur brenda 48 orëve.</p> <p>Ballafaqimi i provimit me zgjidhjen e tezës ndihmon studentin për të kuptuar nivelin e mangësive në njohuri dhe nevojën për të përmirësuar lëndën dhe për të rezultuar me notë më të lartë</p>

<p>studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>apo kalues në provimin e ardhshëm nëse rezultati ka qenë negative.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e brendshme e FEA, 2017</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</p>	<p>Në Kodin e Etikës së UBT-së është e përcaktuar se Plagjatura e çdo forme është shkelje e rëndë e kodit të etikës. Gjithashtu në Rregulloren e FEA është e përcaktuar se kopjimi është shkelje e rëndë. Provimet mbikëqyren të mos lejohet të hyjnë persona të jashtëm, me përjashtim të personave të autorizuar. Sikurse është e shprehur në RVB studenti paraqet mjet identifikimi për të hyrë në provim dhe lejohet në provim vetëm përdorimi i mjeteve ndihmëse. Punimi i mikrotezës shoqërohet me një deklaratë origjinaliteti nga ana e studentit.</p> <p><i>Evidencë 1.14 Kodi i Etikës së UBT.pdf</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>Rezultati i kontrollit të dijeve vjen prej totalit të pikëve të grumbulluara prej studentit në vlerësimin e vazhdueshëm dhe vlerësimin final. Studenti vlerësohet për seminarët, testimet e ndërmjetme, detyrat e kursit dhe provimi final dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p> <p>Sipas Rregullores së programit të studimit vlerësimi hidhet në sistem, i dërgohet studentit brenda 8 ditëve nga data e dhënies së provimit nëse është me shkrim dhe brenda 2 ditësh nëse provimi është me gojë (Rregullore e programit të studimit, <i>Neni 38</i>).</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>Rregullorja e programit të studimit të ciklit të dytë Master Profesional, në Financë Bank përcakton të drejtën e studentëve për të ankimuar vlerësimin e provimit brenda 48 orësh.</p> <p>Studenti sqarohet duke ballafaquar zgjidhjen e realizuar në provim me tezën e zgjidhur. Sipas Rregullores së programit të studimit (<i>Neni 38</i>), komisioni i provimit e ka për detyrë të sqarojë studentin duke ballafaquar zgjidhjen e provimit me tezën e zgjidhur. Mbas afatit 48 orë nota konsiderohet përfundimtare.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e brendshme e FEA, 2017</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga</p>	<p>Studenti ka të drejtë të bëjë ankesë në ditën e provimit nëse ka shkelje të rregullave procedurale ose pas marrjes së vlerësimit,</p>

<p>komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>brenda dy ditëve, siç përcaktohet në rregulloren e programit të studimit.</p> <p>Nëse studenti ngre pretendimin e shkeljes së procedurave ndaj tij, ankesa e studentit shqyrtohet nga Dekani. Dekani pasi shqyrton ankesën mund të thërrasë për sqarime përgjegjës in e departamentit përkatës, komisionin e provimit si edhe vetë studentin. Ai përcakton nëse ankesa e studentit është e drejtë ose jo dhe merr vendimin e tij i cili është i formës së prerë. Nëse ankesa gjykohet e drejt, nota e marrë nga student shpallet e pavlefshme dhe studenti do të rijap provimin me një komision me anëtar të tjerë. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet. Për programin e studimit Master Profesional, në Financë Bankë nuk ka pasur raste të tilla.</p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet me anë të vlerësimit të vazhdueshëm përgjatë vitit.</i> - <i>Institucioni ka vënë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat rrisin transparencën e vlerësimit. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.</i> - <i>Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>	<p style="text-align: center;">X</p>

<p>Standardi III.4</p>	
<p>Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.</p>	
<p>Kriteret</p>	<p>Vlerësimi i ekspertëve</p>
<p>Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të</p>	<p>Programi i studimit të MPFB ka të përfshirë lëndë bashkëkohore të fushës së financës dhe bankës të cilat garantojnë thellimin e njohurive, zhvillimin e aftësive profesionale dhe shkencore të</p>

<p>zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.</p>	<p>studentëve. Lëndët e përfshira në këtë program studimi janë lëndë të cilat formojnë me kompetenca një të diplomuar në fushën e financës dhe bankës. Nëpërmjet diskutimeve dhe përditësimeve të lëndëve dhe orientimi i programit të studimit drejt tregut garantohet njohuri kompetente dhe të veçanta. Në këtë drejtim metodologjia e përdorur në zhvillimin e mësimi dhe forma e vlerësimit janë të rëndësishme për të zhvilluar aftësitë profesionale dhe shkencore, gjë që u shpreh edhe nga studentët.</p> <p><i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB</i></p>
<p>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimi (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>Programi i studimit është i ndërtuar me module (lëndë) të cilat janë ndër modulet kryesore rreth të cilave ndërtohen programet e studimit të këtij drejtimi.</p> <p>Në programin e studimit MPFB janë përfshirë edhe syllabuset e lëndëve të cilat zhvillojnë aftësi të veçanta, të nevojshme dhe të rëndësishme për të krijuar një formim bashkëkohor si Sistemet e Informacionit të drejtimit, Ekonometri, Shërbimet e sigurisë dhe financiare dhe E drejtë financiare dhe bankare.</p> <p>Me anë të këtyre moduleve studenti njeh mënyrën e funksionimit të shërbimeve të cilat do të jenë të rëndësishme gjatë proceseve të punës, apo edhe realizimit të kërkimit shkencor gjatë dhe pas diplomimit në këtë program studimi.</p> <p><i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 3.5 Syllabuse.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.</p>	<p>Syllabuset e lëndëve ofrojnë njohuri të mjaftueshme për të kompletuar studentët me kompetenca në fushën e financës dhe bankës. Gjatë vizitës në institucion pedagogët konfirmuan se në çdo fund semestri analizohen syllabuset. Gjithashtu në çdo fund semestri tërhiqet mendimi i studentëve në lidhje me lëndët që ofrohen në këtë program studimi.</p> <p>Në syllabuset e lëndëve jepen jo vetëm të dhënat e nevojshme në lidhje me semestrin kur zhvillohen, kreditet, detyrimet për tu shlyer si pjesë e vlerësimit, etj, por jepet një përmbledhje dhe rezultatet e të nxëniet që lëndët kanë objektiv të ofrojnë. Në fillim të semestrit studenti njihet me detyrimet përmbyllëse të lëndëve si pjesë e vlerësimit. Në fund të semestrave tërhiqet mendimi i studentëve mbi njohuritë që kanë fituar, kjo nëpërmjet diskutimeve dhe pyetësorit të vlerësimit që plotësojnë studentët në fund të semestrit.</p>

	<i>Evidencë 3.5 Syllabuse Vizita në institucion</i>
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	<p>Metodologjia e ndjekur gjatë zhvillimit të programit të studimit, mundëson që mesimdhënia të bazohet në kompetenca në mënyrë që studentët të përdorin dhe zhvillojnë njohuritë e marra nëpërmjet aplikimit të tyre duke përdorur laboratorët dhe aplikimit gjatë praktikës profesionale.</p> <p>Pedagogët që zhvillojnë mësimin në këtë program studimi janë me grada dhe tituj, janë ekspertë të fushës financë bankë apo të drejtimeve të tjera për të cilat zhvillojnë lëndët. Pedagogët zhvillojnë lëndët me kompetencë, diskutojnë tematika dhe çështje bashkëkohore si dhe nxisin mendimin kritik dhe inovator. Pedagogët nxisin dhe mbështesin diskutimet dhe punën në grup gjatë trajtimit të rasteve studimore dhe përgatitjen e detyrave të kursit. Nëpërmjet bashkëpunimeve institucionale mundësohen praktikat profesionale për një përshtatje sa më të shpejt me tregunë punës dhe për të siguruar njohuri plotësuese për të rritur kompetencat.</p> <p><i>Evidencë 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf Evidencë 3.5 Syllabuse.pdf Vizita në institucion</i></p>
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	<p>Në FEA janë realizuar leksione të hapura në kuadër të projekteve dhe marrëveshjeve ku studentët e këtij programi kanë marrë pjesë. Pedagogët diskutojnë vazhdimisht për zhvillimet më të fundit të fushave të studimit të financës dhe bankës dhe përshtatjen e kurrikulës. Nuk ka informacion në lidhje me orë të hapura të realizuara nga personeli akademik efektiv dhe me kontratë mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit, megjithatë duke qenë ekspert fushe ndërthurin teorinë me eksperiencën.</p> <p>Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u informua nga stafi akademik se janë zhvilluar leksione të hapura me lektorë vendas dhe të huaj në të ftuar për leksione të hapura apo edhe si pjesë e projekteve të institucionit.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative,	Ky program studimi ka karakter profesional dhe kërkimi nxitet në atë drejtim. Studentët nxiten të zhvillojnë kërkimin shkencor

studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	<p>në kuadër të zhvillimit të mikrotezës dhe detyrave të kursit/projekteve. UBT zhvillon konferencë studentore, e fundit e zhvilluar në vitin 2021 dhe studentë të këtj masteri kanë marrë pjesë, gjë që na u tha gjatë vizitës dhe është shprehur edhe në RVB. Gjithashtu studentët nxiten të marrin pjesë në konferenca shkencore dhe të botojnë pa pagesë artikuj në revista shkencore në revista të ndryshme përfshirë edhe revistën e që publikon njësis kryesore FEA “Ekonomia dhe Agrobiznesi”.</p> <p><i>Evidencë 0.1 RVB_MPFB.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>		
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Programi i studimit të MPFB garanton thellimin e njohurive, dhe zhvillon aftësitë profesionale dhe zhvillimin e aftësive të veçanta në fusha të tjera.</i> - <i>Syllabuset e lëndëve ofrojnë njohuri të mjaftueshme për të kompletuar studentët me kompetenca në fushën e financës dhe bankës dhe në përfundim të lëndës tërhiqet opinioni i studentëve.</i> - <i>Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash, duke mbështetur diskutimet dhe punën në grup dhe krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve. Stafi është staf profesionistë me grada dhe tituj.</i> 		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

Standardi III.5	
Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Rregullorja e programit të studimit të MPFB përcakton qartë procedurën që ndiqet për detyrimet përmbyllëse të programit. Sipas Rregullores së programit të studimit (Neni 14), DFK organizon dy sezona diplomimi për çdo vit akademik (shtator dhe mars të çdo viti), datat e zhvillimit përcaktohen nga drejtuesi i njësisë kryesore FEA.

	<p>Studenti ka të drejtë të hyjë në sezonin më të afërt të diplomimit pasi ka shlyer detyrimet e kurrikulës. Nota mesatare e studentëve që mund të përgatisin punim diplome është 6.5 e lart. Studenti që plotëson kriterin e notës mesatare ka të drejtë të paraqesë kërkesën në lidhje me punimin e diplomës që kërkon të zhvillojë dhe udhëheqësin e saj. Studentët orientohen nëpërmjet një liste temash të fushës për të cilën kanë studiuar dhe drejtohen nga pedagogu udhëheqës. Për studentët të cilët përmyllin studimet me provim ju ofrohet program i përgjithshëm i provimit përfundimtar, program i cili shpallet në web të njësisë kryesore sipas Rregullores së programit të studimit (Neni 14).</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmyllëse.</p>	<p>Për zhvillimin e temës së diplomës studentët udhëhiqen nga pedagogët të cilët ndihmojnë me ide dhe materiale.</p> <p>Studentët orientohen se si të ndërtojnë temën e diplomës. Në përfundim të temës së diplomës merret aprovimi nga udhëheqësi i punimit për të mbrojtur temën në juri, gjë që u konfirmua edhe gjatë vizitës. Sipas RVB-së dhe komunikimit gjatë vizitës, studentët të cilët do të zhvillojnë provimin e formimit iu jepet paraprakisht programi i provimit përfundimtar që konsiston në një listë me pyetje dhe ushtrime kryesisht të lëndëve të profilit.</p> <p><i>Evidencë 01. RVB_MPFb.pdf</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>Sipas Rregullores së brendshme të FEA (Neni 46), dhe Rregullores së programit të studimit (Neni 14), për zhvillimin e provimit të formimit ngrihet një komision i posaçëm.</p> <p>Komisioni propozohet nga përgjegjësi i Departamentit të Financë Kontabilitetit dhe miratohet nga Dekani. Studentët të cilët zhvillojnë provimin e formimit marrin në semestër të parë listën e pyetjeve dhe ushtrimeve kryesisht të lëndëve të formimit me karakter profesional të zhvilluar përgjatë dy viteve të studimit. Provimi organizohet me gojë (Rregullore e programit të studimit, Neni 14) para një komisioni të posaçëm të përbërë nga pedagogë të departamentit nga fushat që mbulon programi i provimit. Teza e provimit përmban pyetje nga fushat që përfshihen në programin e provimit dhe përgatitet nga</p>

	<p>anëtarët e komisionit të provimit mbështetur në fondin e pyetjeve që krijohet në përputhje me peshën specifike dhe rëndësinë e çdo fushe. Edhe në rastin kur studenti i përmbyll studimet me temë diplome komisioni i ngritur bënë vlerësimin final në bazë të punimit dhe prezantimit.</p> <p><i>Evidencë 1.4 Rregullore e brendshme e FEA, 2017</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>Departamenti i Financë Kontabilitetit bënë shpërndarjen e udhëheqjeve të temave të diplomës. Udhëheqësit janë pedagogë me grada dhe me tituj.</p> <p>Në RVB përcaktohet që nëse ndodh që departamenti nuk ka numër të mjaftueshëm staf akademik me grada dhe tituj atëherë i plotëson me pedagogë të tjerë të fushave të ngjashme apo me specialist të institucioneve kërkimore shkencore.</p> <p>Udhëheqësi drejton studentin gjatë punimit, që në përcaktimin e temës dhe në vijim në çështjet nënçështjet, metodat e përdorura për vlerësim, konkluzionet, etj. Sipas Rregullores së programit të studimit, udhëheqësi përgatit planin e punës duke vendosur edhe afate të zhvillimit të punimit. Udhëheqësi cakton edhe data konsultimesh në lidhje me punimin, si për të orientuar ashtu edhe për të kontrolluar ecurinë.</p> <p><i>Evidencë 01. RVB_MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Institucioni vë në dispozicion të procesit mësimor dhe zhvillimit të temave të diplomave (mikrotezave) labororët. Studentët e programit MPFB shfrytëzojnë internetin për të marrë informacione të nevojshme. Gjithashtu ata shfrytëzojnë kompjuterat e labororëve për të zhvilluar detyrat e kursit, projektet apo punimin e mikrotezës. Në kompjutera janë të instaluar softwarët që nevojiten për fusha të caktuara që trajtohen në punime. Kjo gjë gjendet në RVB dhe u konfirmua gjatë vizitës në institucion nga studentët. Në dokumentat e dorëzuara përmenden labororët dhe GVJ i verifikoi ato fizikisht.</p> <p><i>Evidencë 01. RVB_MPFB.pdf</i> <i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të</p>	<p>Në rregulloren e programit të studimit (Neni 29) është e përcaktuar mënyra e vlerësimit. Në përfundim të mbrojtjes së</p>

<p>përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>punimit të diplomës apo provimit përfundimtar student vlerësohet me notë ku minimum kalues është 5 (pesë) dhe maksimumi është 10 (dhjetë).</p> <p>Në përmbyllje të studimit si në rastin e mbrojtjes së mikrotezës, edhe në rast se programi i studimit përmbyllet me provim formimi me gojë, sipas rregullores së programit të studimit (<i>Neni 14</i>), rezultatet e provimit të formimit dhe të temës së diplomës u jepen studentëve në fund të çdo dite provimi. Studenti ka të drejtë të paraqes ankesë nëse e konsideron të padrejtë vlerësimin dhe komisioni i provimit e merr në shqyrtim ankesën përpara se të marrë vendimin përfundimtar.</p> <p>Nëse gjatë ballafaqimit konstatohet se është bërë gabim gjatë vlerësimit, atëherë bëhet ndryshimi i vlerësimit. Në përfundim, komisioni hedh notën në sistem, printon procesverbalin i cili firmoset nga të gjithë anëtarët e Komisionit të Provimit si edhe më pas nga personat e tjerë përgjegjës.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>Në përfundim të studimeve, sipas Rregullores së institucionit, Rregulloren e FEA dhe Rregulloren e programit të studimeve, studenti pajiset me diplomën “Master Profesional” në programin e studimit përkatës të firmosur nga Dekani dhe Rektori i UBT-së. Së bashku me diplomën studentit merr listën e notave dhe suplementin e diplomës sipas modelit të miratuar.</p> <p><i>Evidencë 1.3 Rregullore e Studimeve Universitare</i> <i>Evidencë 1.4 Rregullore e brendshme e FEA, 2017</i> <i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>
<p>Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.</p>	<p>Në rregulloren e FEA (<i>Neni 101</i>), është e përcaktuar se UBT dhe FEA ruan të dhënat e studentëve. Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave të studentëve në bazë të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.</p> <p>Ruajtja dhe përpunimi i të dhënave personale të studentëve realizohet në bazë të parimit të konfidencialitetit. Gjithashtu në rregullore përcaktohen edhe dokumentacioni që lëshohet me kërkesë të studentëve si pjesë e shërbimeve të ofruara për studentët. Në Rregulloren e institucionit (<i>Neni 105</i>) është e shprehur se pranë UBT është ngritur sekretaria mësimore dhe e shërbimit për studentët. Objekti i sekretarisë mësimore dhe e</p>

	<p>shërbimit për studentët është regjistrimi i studentëve, mbajtja e bazës së të dhënave për studentët dhe rezultatet e tyre.</p> <p>Në sekretari mbahet dokumentacioni mbi rezultatet e pjeshme dhe të plota të studentëve. Administrohen procesverbalet e provimeve të të gjitha lëndëve, gjë të cilën GVJ e verifikoi fizikisht në vend. Sekretaria lëshon dokumente të ndryshme të miratuara nga Rektorati. Gjatë vizitës në institucion GVJ vizitoi sekretarinë mësimore dhe informacionet për studentët si të dhënat e përgjithshme, formularët e regjistrimit, procesverbalet e notave, plotësimi i regjistrave bëhet në regjistra në formate të përcaktuara sipas akteve ligjore në fuqi.</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni nëpërmjet rregulloreve, përfshirë edhe rregulloren e programit të studimit të MPFB përcakton qartë procedurën që ndiqet për detyrimet përmbyllëse të programit. - Institucioni vë në dispozicion të procesit mësimor dhe zhvillimit të temave të diplomave (mikrotezave) ambientet dhe teknologjinë e institucionit. - Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën, listwn e notave dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin, kopje të dokumentacionit të studentit ruhen nga institucioni. 			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6	
<p>Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose</p>	<p>Programi i studimit të MPFB ofrohet nga Departamenti i Financë Kontabilitetit të FEA. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit është fakulteti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit.</p>

<p>jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ka në mjediset e saj laboratorë për module aplikative dhe laboratorë informatike të mjaftueshëm për realizimin e praktikës laboratorike. Praktikrat profesionale zhvillohen pranë institucioneve dhe ndërmarrjeve me të cilat FEA ka lidhur marrëveshje.</p> <p><i>Evidencë 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke</i></p>			
<p>Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.</p>	<p>Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit është institucioni përgjegjës për programin e studimit dhe për përmbushjen e realizimit të praktikave. Për këtë qëllim institucioni ka lidhur marrëveshje me organizma, institucione dhe ndërmarrje në mënyrë që studentët të përfitojnë njohuri dhe kompetenca praktike. Praktikrat zhvillohen nën mbikqyrje të stafit akademik të përcaktuar.</p> <p><i>Evidencë 1.17 Raport i Bashkëpunimit Institucional të UBT brenda dhe jashtë vendit, 2022</i></p>			
<p>Kriteri 3. Praktikrat profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.</p>	<p>Studentët i zhvillojnë praktikrat profesionale dhe e dokumentojnë me relacion që behet nga studenti dhe me vlerësim nga institucioni ku kryhet praktika. Praktika vlerësohet nga komisioni i ngritur me vlerësimin fiton ose nuk fiton, dhe nëse nuk fiton studenti shpallet përsëritës. Praktika profesionale është e vlerësuar me 20 ECTS në planin mësimor të programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB</i></p>			
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Njësia kryesore ka në mjediset e saj laboratorë për module aplikative dhe laboratorë informatike të mjaftueshëm për realizimin e praktikës laboratorike.</i> - <i>Institucioni ka lidhur marrëveshje me organizma, institucione dhe ndërmarrje në mënyrë që studentët të përfitojnë njohuri dhe kompetenca praktike.</i> - <i>Studentët i zhvillojnë praktikrat profesionale dhe i dokumentojnë sipas rregullores. Praktika profesionale vlerësohet me kredite.</i> 			
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të dosjes së vetëvlerësimit (RVB) dhe informacionin e marrë në takimet e realizuara gjatë vizitës në Universitetin Bujqësor (UBT), GVJ konstatoi se institucioni mban të dhëna të plota mbi personelin e angazhuar në këtë program studimi, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe statutin e UB. Referuar evidencës së tabelave përmbledhëse nr. 6, të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike paraqiten si vijon:</p> <p>Për vitin akademik 2020-2021 janë të angazhuar 20 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 17 PAE , nga të cilët 9 të kategorisë “Profesor” dhe 8 me gradën “Doktor”, • 3 PAK, nga të cilët 2 të kategorisë “Profesor” dhe 1 me gradën “Doktor”. <p>Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është 85% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2021-2022 janë të angazhuar 19 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 16 PAE , nga të cilët 10 të kategorisë “Profesor” dhe 6 me gradën “Doktor”, • 3 PAK, nga të cilët 2 të kategorisë “Profesor” dhe 1 me gradën “Doktor”.

	<p>Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është 84% nga PAE.</p> <p>Për vitin akademik 2022-2023 janë të angazhuar përsëri 19 pedagogë:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 16 PAE , nga të cilët 10 të katëgorisë “Profesor” dhe 6 me gradën “Doktor”, • 3 PAK, nga të cilët 2 të katëgorisë “Profesor” dhe 1 me gradën “Doktor”. <p>Mbulimi i programit në përqindje për këtë vit akademik është 84% nga PAE.</p> <p>Nga shqyrtimi i CV të personelit akademik, GVJ konstatoi se stafi i angazhuar në këtë program studimi ka fushë kërkimore në përputhjen me natyrën dhe veçoritë e lëndëve të ofruara në këtë program studimi. Departamenti përgjegjës për programin e studimit, departamenti i Financës dhe Kontabilitetit ka të angazhuar një personel ndihmës-administrativ, i cila ndihmon aktivitetin mësimor dhe kërkimor të departamentit nëpërmjet kryerjes së detyrave të ndryshme për të cilat ka nevojë stafi akademik i departamentit.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i> <i>Evidencë nr. 3,4 CV e stafit;</i> <i>Evidencë nr. 3.4.1 CV e stafit ndihmës akademik;</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaton se mbulimi i ngarkesës mësimore të programit të studimit bëhet në përputhje me aktet ligjore në fuqi. Pedagogët që japin mësim në këtë program studimi kanë të paktën gradën shkencore “Doktor” dhe 84% e ngarkesës mbulohet nga personeli akademik efektiv. Pedagogët e angazhuar në mësimdhënie janë edhe udhëheqës të temave të diplomës së studentëve.</p> <p><i>GVJ konstatoi se një pjesë e pedagogëve kishin mbingarkesë, jo vetëm në numër lëndësh por edhe në orë mësimore.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i> <i>Evidencë nr. 3.4 CV e stafit;</i> <i>Evidencë nr. 3.4.1 CV e stafit ndihmës akademik;</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e</p>	<p>Institucioni në strukturën e tij ka ngritur Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave (DMBNJP), e cila në organikën e saj ka Zyrën e Burimeve Njerëzore. Zyra e</p>

<p>personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.</p>	<p>Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për mbledhjen, ruajtjen dhe përditësimin e të dhënave të personelit të angazhuar në programin e studimit me kohë të plotë dhe me kontratë. Veprimtaria e zyrës mbështetet në Rregulloren e DMBNJP.</p> <p>Gjatë takimit me personelin e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ konstatoi se kjo zyrë disponon të dhëna mbi anëtarët e personelit akademik dhe ndihmës akademik të angazhuar në programet e studimit që ofron ky institucion.</p> <p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstaton një qëndrueshmëri të personelit akademik të përfshirë në këtë program studimi dhe në Departamentin e Financë-Kontabilitetit në përgjithësi. Gjatë tre viteve të fundit akademik të raportuar, pothuaj 90% e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit është i njëjtë.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.8 Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, 2018.pdf;</i> <i>Evidencë nr. 3.4 CV e stafit;</i> <i>Evidencë nr. 3.4.1 CV e stafit ndihmës akademik;</i> <i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.</p>	<p>Statuti i UBT në bazë të legjislacionit në fuqi, përcakton kriteret dhe procedurat që ndiqen në rekrutimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik. Kriteret e përgjithshme përcaktohen në rregulloren e UBT, ndërsa ato specifike në rregulloren e njësisë bazë.</p> <p>Institucioni ka miratuar rregulloren për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ, ku përcaktohen procedurat dhe kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për secilën kategori të stafit. Shpallja e vendeve vakante dhe kriterëve specifike bëhet në faqen e internetit të institucionit dhe publikohen në APP. Rekrutimi i personelit kryhet nga një komision i posaçëm me pesë anëtarë për PAE (tre anëtarë për PAK): një nga Rektorati, një nga Drejtoria Burimeve Njerëzore, dhe tre anëtarë nga njësia kryesore. Vlerësimi i aplikantëve bëhet sipas një strukture pikësimi të përcaktuar qartë në rregulloren e rekrutimit të personelit akademik.</p> <p>Dosja e aplikantit vlerësohet maksimumi me 70% të totalit të pikëve, ndërsa 30% tjetër i pikëve i akordohet intervistës.</p>

	<p>Rekrutimi i pedagogëve të ftuar ndjek të njëjtën procedurë, por përzgjedhja e tyre bëhet me dosje. Nga shqyrtimi i dosjeve të personelit akademik dhe CV e tyre, GVJ konstatoi se personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi ka nivelin e duhur akademik dhe kërkimor shkencor në përputhje me përmbajtjen e moduleve apo lëndëve që ata japin mësim.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.10 Rregullore për rekrutimin e stafit akademik, ndihmës dhe administrativ”</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>Në mbështetje të procesit mësimor dhe aktivitetit kërkimor-shkencor, institucioni ka angazhuar një staf administrativ dhe ndihmës akademik prej tetë personash në nivel njësie kryesore (një nga të cilët është personel ndihmës akademik në nivel njësie bazë), të cilët angazhohen në mirëmbajtjen e pajisjeve didaktike, të laboratorëve dhe ambienteve të tjera mësimore.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.</p>	<p>UBT sipas organigramës së re të tij, ka ngritur Drejtorinë e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike (ish Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave), e cila funksionon në bazë të rregullores së saj të hartuar në përputhje me Ligin 80/2015, Statutin e UBT dhe Rregulloren e UBT. DBNSHJ është e organizuar në tre sektorë, një nga të cilët është Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve. Sektori i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimeve është përgjegjës për administrimin e dosjeve të personelit akademik, ndihmës akademik dhe administrativ.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ shqyrtoi në mënyrë rastësore dosjen personale të dy pedagogëve të programit të studimit dhe konstatoi se dosja ishte e plotësuar me dokumentet e nevojshëm si: CV, vërtetimin nga gjykata, dokumentin e Diplomës, dokumentet e gradave/titujve shkencorë, vërtetime mbi kualifikimin, kontratën e punës, librezën shëndetësore, si edhe raportin e vlerësimit të performancës së pedagogut.</p>

	<p><i>Evidencë nr. 1.8 Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, 2018.pdf</i></p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale UBT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi në nivel institucioni dhe njësie kryesore me përfaqësues të institucioneve publike dhe të bizneseve private, të cilat u mundësojnë edhe realizimin e praktikave profesionale studentëve të këtij programi studimi.</p> <p>Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në këtë program studimit, është i angazhuar për të asistuar studentët lidhur me zhvillimin e praktikës profesionale dhe në udhëheqjen e punimit të diplomës për studentët që mbrojnë diplomën me temë.</p> <p>Plani mësimor i programit të studimit parashikon 120 orë në auditor dhe 180 orë jashtë auditorit për realizimin e praktikës profesionale e cila zhvillohet në semestrin e katërt, me shkëputje nga procesi mësimor.</p> <p><i>Evidencë nr. 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. 3.3.2.2 Plani mësimor i programit MPFB 2021-2022.pdf</i></p>
<p>Kriter 8. Personeli mbikëqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale UBT ka lidhur 123 marrëveshje bashkëpunimi me universitete dhe institucione të ndryshme, të cilët u garantojnë dhe ofrojnë mjediset e tyre studentëve për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe asimilimin e njohurive teorike dhe praktike nga studentët e këtij program studimi.</p> <p>Nëpërmjet kontratës që nënshkruhet për zhvillimin e praktikës profesionale të programit të studimit Master Profesional Financë-Bankë, insitucioni/ndërmarrja ku zhvillohet praktika merr përsipër të asistojë dhe të monitorojë studentin që zhvillon praktikën nëpërmjet angazhimit të një punonjësi të tij; të krijojë kushte lehtësuese për zhvillimin e praktikës, si dhe në përfundim të bëjë një vlerësim me shkrim mbi punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale. Vlerësimi i dërgohet zyrtarisht fakultetit në përfundim të praktikës dhe merret në konsideratë për vlerësimin përfundimtar të praktikës profesionale.</p> <p><i>Evidencë nr. 3.6.1 Kërkesa dhe Kontrata për Praktikë Profesionale në MP_FB.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p>

	<p>- Personeli akademik që angazhohet në këtë program studimi përmbush kërkesat ligjore në fuqi dhe ka nivelin e kërkuar të kualifikimit akademik për mësimdhënie në programin e studimit.</p> <p>- Personeli akademik i DFK i angazhuar me kohë të plotë dhe me kontratë në këtë program studimi është i qëndrueshëm.</p> <p>- Pranë FEA angazhohet personel ndihmës i kualifikuar për realizimin e aktiviteve ndihmëse të procesit akademik.</p> <p>- Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike mbledh, ruan dhe përditëson të dhënat e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit.</p> <p>- Marrëveshjet e bashkëpunimit që institucioni ka nënshkruar me përfaqësues të biznesit dhe institucione private dhe publike, garantojnë infrastrukturën e nevojshme për kryerjen e praktikës profesionale të studentëve të këtij program studimi. FEA ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi për realizimin e praktikave profesionale dhe ka përgatitur udhëzues për realizimin dhe vlerësimin e praktikës profesionale dhe të temës së diplomës.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të	<p>Gjatë vizitës në institucion u konstatua se Institucioni siguron mjediset të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore. Fakulteti i Ekonomisë dhe Agrobiznesit ushtron veprimtarinë në dy godina A dhe B, të cilat janë rinovuar dhe pajisur me mjetet dhe pajisjet e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor. Sipas dokumentacionit bashkëngjitur RVB, veprimtaria e mësimdhënies zhvillohet në:</p> <ul style="list-style-type: none"> • 14 salla leksioni, • 26 salla seminari,

<p>programit të studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • 2 salla për zhvillimin e aktiviteteve të ndryshme si praktika profesionale, konferenca etj., • 8 laboratorë, • 1 sallë biblioteke dhe interneti, • zyra për stafin drejtues, personelin akademik dhe ndihmës akademikë, dhe • ambiente të tjera shërbimi në funksion të procesit mësimor dhe punës kërkimore shkencore. <p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se institucioni siguron mjedise të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ vizitoi disa salla leksionesh dhe seminaresh, laboratorët, bibliotekën dhe mjedise të tjera dhe vuri re që mjediset mësimore ishin të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe sisteme fonie si dhe kanë ndriçim optimal të cilat mundësojnë përdorimin e teknologjisë bashkëkohore mësimore si nga stafi akademik edhe nga studentët. Rinovimi dhe pajisja e mjedisve mësimore është mundësuar jo vetëm nga fondet e përfituar nga buxheti i shtetit por edhe nga të ardhurat e realizuara nga projektet në të cilat është angazhuar personeli i UBT.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Sallat ku zhvillohet mësimi i programit të studimit Master Profesional në Financë Bankë janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit si PC, projektorë dhe pajisje fonie e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.</p>	<p>Në FEA janë ngritur nëntë laboratorë: katër laboratorë informatike, tre laboratorë për realizimin e moduleve specifike, dy laboratorë për praktikë profesionale dhe aktivitete të ndryshme dhe një laborator për zhvillimin e gjuhëve të huaja.</p> <p>Studentët frekuentojnë laboratorët për zhvillimin e detyrave/projekteve të kursit dhe punimit të diplomës.</p> <p>Nga shqyrtimi i planit mësimor GVJ konstaton se programi i studimit “Master Profesional në Financë Bankë” nuk ka kërkesa specifike për laboratorë të dedikuar dhe nuk parashikon realizimin e orëve të detyrueshme laboratorike.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i> <i>Evidencë nr. 3.3.2 Plani mësimor i programit MPFB.pdf</i> <i>Evidencë nr. 3.3.2.2 Plani mësimor i programit MPFB 2021-2022.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatore me kapacitetet e nevojshme.</p>	<p>Për realizimin e praktikës profesionale UBT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione të ndryshme, të cilët u garantojnë dhe ofrojnë mjediset e tyre studentëve për plotësimin e kërkesave të moduleve dhe asimilimin e njohurive teorike dhe praktike nga studentët e këtij program studimi. Praktika profesionale zhvillohet gjatë semestrit të katërt me shikim nga procesi mësimor në mjediset e institucionit pritës sipas kontratës për praktikën profesionale të miratuar nga palët.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.22 Lista e marrëveshjeve 2022 .pdf</i> <i>Evidencë nr. 3.6.1 Kërkesa dhe Kontrata për Praktikë Profesionale në MP_FB.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UBT siguron ambiente të mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarive mësimore.</i> - <i>Ambjentet mësimore dhe mjediset e tjera ndihmëse janë të pajisura me infrastrukturën dhe teknologjinë e nevojshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies.</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve laboratorë të teknologjisë së informacionit dhe ambiente të tjera në funksion të procesit mësimor dhe kërkimor. - UBT garanton zhvillimin e praktikës profesionale dhe veprimtarive të tjera profesionale në mjedise të përshtatshme nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura me institucione dhe subjekte të tjera. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	<p>Nga shqyrtimi i syllabuseve, GVJ konstatoi se në pothuajse të gjitha lëndët ofrohen tituj të larmishëm në literaturë (të detyrueshëm dhe të sugjeruar) në dispozicion të studentëve. Literatura e rekomanduar, në gjuhë shqipe dhe gjithë të huaj, është në përputhje me programet përkatëse të lëndëve. Përveç teksteve që gjenden në bibliotekën e FEA, pedagogët vënë në dispozicion të studentëve përmbledhje me slide apo ushtrime dhe raste studimore për lëndët përkatëse.</p> <p><i>Evidencë nr. 3.5 Syllabuse.pdf</i></p>
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësimet të literaturës me botime të viteve të fundit.	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik angazhohet në përmirësimin dhe përditësimin e literaturës që ofrohet në modulet e programit të studimit. Literatura e ofruar është objekt i diskutimit të analizës vjetore të departamentit. Përveç teksteve të botuar nga profesorë të Departamentit të Financë-Kontabilitetit, sugjerohen edhe tekstet e huaja universitare të përkthyer në gjuhën shqipe, si dhe artikuj të ndryshëm shkencorë, duke u dhënë mundësi studentëve të punojnë me raste konkrete studimore dhe të njohën me zhvillimet e fundit të fushës financiare dhe bankare.</p> <p><i>Evidencë nr. 3.5 Syllabuse.pdf</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>Studentët e programit të studimit “Master Profesional në Financë Bankë” kanë në dispozicion Bibliotekën e UBT “Mentor Përmeti” dhe Bibliotekën e FEA, ku janë depozituar edhe tekset dhe materialet mësimore të programit të studimit. Studentët kanë mundësi të punojnë në bibliotekë ose të marrin materialet, kundrejt anëtarësimit me kartelë identifikimi dhe pa pagesë.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.18 Informacion nga Bibloteka Shkencore Mentor Përmeti.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>Nga vizita në këtë bibliotekë, si dhe informacioni paraqitur në RVB dhe dokumentacionin shoqërues, rezultoi se biblioteka disponon literaturë fizike të nevojshme në mbështetje të këtij programi studimi dhe të programeve të tjera të UBT si: tekste mësimore bazë në gjuhën shqipe; tekste mësimore dhe materiale ndihmëse në gjuhë të huaj; libra, periodikë, monografi, revista shkencore kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.18 Informacion nga Bibloteka Shkencore Mentor Përmeti.pdf</i> <i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.</p>	<p>Përveç literaturës fizike që gjendet në ambjentet e bibliotekave, studentët kanë mundësi të përdorin pa pagesë edhe bibliotekat online të ofruara nga institucioni. Institucioni ka vënë në dispozicion të personelit akademik dhe studentëve disa platforma online si: Edward Edgar Publshing, IOPSCIENCE, Cobiss, Jstore etj, ku ata kanë akses në literaturë në gjuhë shqipe dhe në gjuhë të huaj.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.</p>	<p>Sallat e bibliotekave kanë internet dhe janë të pajisura me kompjutera që kanë të instaluar programe që u mundësojnë studentëve aksesin në bibliotekën elektronike. Bazuar në dokumentacionin e RVB dhe nga vizita në mjediset e bibliotekave, salla e bibilotekës së UBT ka një kapacitet prej 50 poste, ndërsa salla e FEA ka një kapacitet prej 100 poste dhe në secilën prej tyre janë instaluar rreth 10 kompjutera.</p>

	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ iu konfirmua se biblioteka frekuentohej vazhdimisht nga studentët jo vetëm për të tërhequr libra apo materiale mësimore por edhe si sallë studimi/leximi.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.18 Informacion nga Bibloteka Shkencore Mentor Përmeti.pdf</i> <i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.</p>	<p>Orari i shërbimit fizik të bibliotekës është 8.30-16.00 nga e hëna në të premte. Biblioteka e UBT është e dixhitalizuar në saj të bashkëpunimit me Rrjetin Akademik Shqiptar, që i jep mundësi përdoruesve të aksesojnë në çdo kohë on-line materialet mësimore dhe informacionin shkencor që kërkojnë në gjuhë shqipe dhe të huaj.</p> <p><i>https://www.ubt.edu.al/fea</i></p>
<p>Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua mbi angazhimin e institucionit për pasurimin e vazhdueshëm të bibliotekës me titujt të rinj në mbështetje të të gjithë programeve të studimit. Personeli akademik në bashkëpunim me drejtuesit e strukturave hartojnë plane për të shtuar literaturën e bibliotekës çdo vit akademik. Gjithashtu pedagogët depozitojnë në bibliotekë edhe kopje të teksteve të tyre mësimore që janë në funksion të programit të studimit.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Literatura bazë dhe ndihmëse është në përputhje me programin e studimit dhe mundëson arritjen e objektivave të tij.</i>

	<p>- Institucioni ka vënë në dispozicion të studentëve dhe stafit akademik bibliotekën me tituj fizikë dhe disa platforma online, duke mundësuar akses dhe shfrytëzim optimal të literaturës së ofruar.</p> <p>- Institucioni angazhohet në përditësimin e vazhdueshëm të bibliotekës fizike dhe online me tituj të rinj.</p>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.</p>	<p>UBT, përfshirë edhe FEA si pjesë përbërëse e tij, kanë instaluar sistemin e menaxhimit të informacionit Pitagora nëpërmjet të cilit bëhet administrimi i informacionit lidhur me studentët, personelin akademik dhe administrativ.</p> <p>Në bazë të akteve ligjore dhe rregullatore të institucionit, i gjithë informacioni lidhur me studentët dhe aktivitetin e tyre menaxhohet nga Zyra e Studimit dhe Studentëve. ZSS kryen funksionin e saj sipas kriterëve të përcaktuara në statut dhe rregulloren e studimeve të UBT (<i>Neni 105</i>) dhe në rregulloren e Degës së Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (DZHKKV) (sipas organigramës së re ka emërtimin Drejtoria e Shërbimeve Mësimore dhe Studentëve). Sipas <i>Nenit 14</i> të rregullores së DZHKKV, ZSS është përgjegjëse për</p> <ul style="list-style-type: none"> • Rregjistrimin e studentëve dhe mbajtjen e bazës së të dhënave mbi studentët dhe rezultatet e tyre në formë dokumentare dhe elektronike; • Plotësimin dhe dorëzimin e të gjithë dokumenteve individuale çertifikues mbi rezultatet e pjeshme ose të plota të studimeve; • Mbajtjen e dokumentacionit dhe ndjekjen e ecurisë së procesit mësimor

	<ul style="list-style-type: none"> • Mbajtjen e bazës së të dhënave mbi studentët dhe certifikimin individual të studimeve të kryera; • Ofrimin e shërbimeve dhe informimin për studentët në nivel Universiteti <p>Gjatë vizitës në ambjentet e sekretarisë dhe njohjen me dokumentacionin e ZSS, GVJ konstatoi se institucioni menaxhon dhe ruan të dhënat e studentëve në rregjistrat përkatës nga rregjistrimi deri në diplomimin e tyre.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.6 Rregullore DZHKKVI _DITNJ Final_V.2017 .pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se UBT ka ngritur një sistem të brendshëm të menaxhimit të informacionit. Dokumentacioni kërkimor dhe shkencor lidhur me personelin akademik administrohet nga departamenti i Financë Kontabilitetit. Dokumentacioni administrativ lidhur me personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrativ administrohet nga Sektori i Burimeve Njerëzore i cili është një strukturë në varësi të Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Juridike. Kjo zyrë ka për funksion të kryejë procedurat për lidhjen e kontratave të punës dhe akt-marrëveshjeve, menaxhojë dokumentacionin personal të punonjësve dhe rregjistrave themeltar, protokollomin, arkivimin dhe menaxhimin e dokumentacionit lidhur me personelin e UBT etj. Zyra e Burimeve njerëzore e ushtron aktivitetin e saj në bazë të rregullores DMBNJP.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.8 Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, 2018.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Sistemi i menaxhimit të informacionit menaxhohet nga zyrat përkatëse dhe siguron akses të dedikuar për të gjithë përdoruesit e tij. Informacioni është i disponueshëm për të gjithë personelin dhe studentët në forma të ndryshme:</p> <ul style="list-style-type: none"> • On line nëpërmjet faqes zyrtare të internetit të institucionit, nëpërmjet sistemit Pitagora ku studentët mund të logohen me anë të një user name personal dhe passwordi dhe të marrin informacion mbi vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar të çdo lënë, si dhe nëpërmjet websitet personal (klasën virtuale) të çdo



	<p>pedagogu ku mund të konsutojnë materialet lidhur me procesin mësimor.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Kundrejt miratimit nga institucioni të kërkesës të të interesuarve (personeli dhe studentët) mund të marrin informacion në formë “hard copy” në zyrat përkatëse të institucionit. <p><i>Evidencë nr. 1.8 Rregullore e Drejtorisë së Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe Pagave, 2018.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se edhe studentët edhe personeli akademik kanë adresa emaili me domain-in e institucionit dhe kanë mundësi nëpërmjet platformave online dhe websiteve të pedagogut të komunikojnë dhe të shkëmbejnë informacion lidhur me procesin mësimor.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.21 Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora.PDF</i></p>
<p>Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ u informua që në kuadër të menaxhimit të informacionit të aktivitetit akademik dhe administrativ nëpërmjet platformave online, por edhe nëpërmjet dokumentimit fizik të informacionit, realizohet monitorimi në kohë reale i të gjithë aktivitetit mësimor dhe administrativ nga titullarët në nivel departamenti, njësie kryesore dhe institucioni.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.</p>	<p>Në faqen zyrtare të internetit të UBT gjenden të gjitha informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme në funksion të studentëve, personelit akademik dhe administrativ, bashkëpunëtorëve të institucionit dhe palëve të tjera të interesuara. Informacioni është i aksesueshëm në gjuhën shqipe dhe GVJ iu komunikua se publikimi i tij në gjuhën angleze është në proces.</p> <p>https://www.ubt.edu.al/fea</p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni ka integruar disa platforma për administrimin e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre pranë UBT.</i>

	<ul style="list-style-type: none"> - Sistemi i menaxhimit të informacionit garanton monitorimin në kohë të aktivitetit akademik dhe administrativ të institucionit. - Institucioni publikon në faqen e tij zyrtare të internetit informacion të plotë mbi programet e studimit, personelin akademik dhe aktivitetet e ndryshme të tij. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	<p>Sipas RVB Institucioni harton një raport financiar të kostove mesatare rreth programit të studimit e cila është 116.367 lekë. <i>Por nga shqyrtimi i dokumenteve shoqërues të RVB, GVJ nuk konstaton dokument që mbështet këtë të dhënë. Nga vizita në institucion, rezulton se institucioni harton raport financiar të kostove dhe planin për mbështetje financiare në tërësi për të gjithë institucionin dhe jo në veçanti për programin e studimit apo ciklin e studimit.</i></p> <p>GVJ konstatoi se në nivel njësie kryesore, në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Financës, Drejtorinë e Menaxhimit të Fondeve dhe Investimeve dhe zyra e drejtorit të tjera të institucionit, hartohet një relacion për realizimin e buxhetit mbi baza vjetore dhe një planifikim për vitin pasardhës për secilin fakultet.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF Evidencë nr. 6.1 Relacion per realizimin e buxhetit per vitin 2021 dhe planifikimi per vitin 2022, FEA.PDF; Vizita në Institucion</i></p>

<p>Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.</p>	<p>UBT si insitucion publik funksionon sipas parimit të autonomisë financiare, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”. Sipas Statutit të UBT, projekt buxheti hartohet fillimisht në nivel departamenti, duke plotësuar kërkesat specifike të departamenteve, më pas në nivel fakulteti dhe së fundi në nivel institucioni. Pas vlerësimit nga Senati Akademik projektbuxheti miratohet nga Bordi i Administrimit i UBT.</p> <p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, plani i financimit të institucionit përmban të gjithë zërat që lidhen me realizimin e programit të studimeve të tilla si: financimi i burimeve njerëzore, i shpenzimeve operative, shpenzimeve për përmirësimin e infrastrukturës, teknologjinë, pasurimin e literaturës, grantet vendase apo të huaja të përfituara të përfituara nga marrëvedhjet dhe projektet e fituara nga institucioni etj.</p> <p>Financimi i institucionit realizohet kryesisht nëpërmjet grantit të qeverisë dhe tarifave të studentëve. Aktiviteti kërkimor shkencor financohet nga projektet e fituara në rang kombëtar (AKTI, PKKZH) si dhe ndërkombëtare (Banka Botërore, BE, IPA, Erasmus, Tempus etj.).</p> <p><i>GVJ konstaton se pjesa e fondit të UT që i akordohet aktivitetit kërkimor shkencor është modeste dhe është ulur në vitin 2022 në krahasim me vitin 2021.</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.</p>	<p>Institucioni ka ngritur Njësinë e Auditit të Brendshëm e cila sipas rregullores së saj kryen auditimin e institucionit çdo vit. NJAB ka për detyrë monitorimin e brendshëm të aktivitetit të të gjitha subjekteve të sistemit të UBT dhe treguesve financiarë. Auditimi kryhet në bazë të planit vjetor, i cili aprovohet nga Bordi i Administrimit. Gjithashtu në fund të vitit institucioni i dërgon një raport të detajuar financiar mbi përdorimin e burimeve financiare Ministrisë së Financave. Auditimi i jashtëm kryhet nga auditues të brendshëm ose të jashtëm, të përzgjedhur nga ministria përgjegjëse për arsimin nga lista e përditësuar çdo vit nga Ministria e Financave. Institucioni i nënshtrohet edhe auditimit nga nga Kontrolli i Lartë i Shtetit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë nr. 1.23 Rregullore Sektorit Auditimit të Brendshëm UBT.PDF</i> <i>Evidencë nr. 6.1 Relacion për Realizimin e Buxhetit për vitin 2021 dhe Planifikimi për vitin 2022.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni nuk harton raporte financiare në mbyllje të një cikli të plotë studimi dy vjeçar, por në nivel njësie kryesore. Në bashkëpunim me Drejtorinë Ekonomike dhe Financës, Drejtorinë e Menaxhimit të Fondeve dhe Investimeve dhe zyra e drejtori të tjera të institucionit, hartohet një relacion për realizimin e buxhetit mbi baza vjetore dhe një planifikim për vitin pasardhës për secilin fakultet. Relacioni analizon në mënyrë të detajuar zërat e shpenzimeve dhe të ardhurave gjatë vitit duke bërë edhe krahasime me vitin paraardhës.</p> <p><i>Evidencë nr. 6.1 Relacion për Realizimin e Buxhetit për vitin 2021 dhe Planifikimi për vitin 2022.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Në përputhje me legjislacionin në fuqi, burimet e financimit të UBT janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - buxheti i shtetit nëpërmjet të cilit paguhen pagat e personelit, sigurimet shoqërore dhe dhëndetësore, bursat për studentët dhe investimet; - tarifatat dhe shërbimet ndaj studentëve; - projekte kombëtare dhe ndërkombëtare; - të ardhura nga shërbime të tjera (qera, qendra eksperimentale etj.) <p>Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB, GVJ konstaton se gjatë tre viteve të fundimit, financimi i institucionit realizohet mesatarisht në masën 60%-70% nga qeveria dhe 40%-30% nga të ardhurat e institucionit (tarifat e shkollimit).</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i> <i>Evidencë nr. 6.1 Relacion për Realizimin e Buxhetit për vitin 2021 dhe Planifikimi për vitin 2022.pdf</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT harton raporte financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në nivel universiteti dhe bën analiza financiare në nivel njësie kryesore por jo në nivel njësie bazë apo sipas programeve dhe cikleve të studimit. - Institucioni kryen auditim të brendshëm nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në varësi të Bordit të Administrimit të UBT dhe auditim të jashtëm nga KLSH .

	<ul style="list-style-type: none"> - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij në bazë të kuadrit rregullator në fuqi. - UBT si institucion buxhetor, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1

Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>UBT ka hartuar dhe miratuar akte rregullatore në përputhje me aktet ligjore në fuqi (statuti dhe rregullorja e institucionit, rregullorja e njësisë kryesore, rregullorja e programit të studimit) të cilët përcaktojnë politika dhe procedura të qarta që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve të programit të studimit “Master Profesional në Financë Bankë” dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe Statutin e UBT.</p> <p>Në veçanti rregullorja e programit të studimit përcakton qartë objektivat dhe misionin e programit të studimit, strukturën mësimore, procedurat dhe kriteret që nga pranimi i studentëve, regjistrimi, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi i tyre, ekuivalentimi i moduleve, njohja e krediteve dhe transferimi i studimeve, fitimi i statutit të studentit etj.</p> <p><i>Evidencë nr. 1. 1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i></p>

	<p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>Politikat dhe procedurat e përcaktuara në aktet rregullatore bëhen publike dhe u bëhen të njohura studentëve, duke garantuar barazi, konkurrencë të drejtë për të gjithë kandidatët që aplikojnë për të kryer studimet në programin e studimit Master Profesional në Financë Bankë, si dhe për studentët gjatë viteve të ndjekjes së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.</p>	<p>Neni 42 në Rregulloren e Brendshme të FEA përcakton se kriteret e pranimit të kandidatëve në programin e studimit përcaktohen nga departamenti përgjegjës i programit të studimit. Kriteret behen publike nga FEA dhe QSHA dhe miratohen sipas përcaktimeve në Statutin e UBT dhe sipas udhëzimeve të MASR. Pranimi në programin e studimit Master Profesional në Financë Bankë është i mundur për të gjithë studentët që zotërojnë një diplomë të ciklit të parë të studimeve si dhe plotësojnë kriteret meritës dhe rëndësisë të miratuara Departamenti i Financë-Kontabilitetit. Programet e studimit, kuotat dhe kriteret e pranimit bëhen publike në faqen zyrtare online të institucionit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.10 Propozimi i Krihereve për Pranimin e Studentëve 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.10.1 Propozimi i Krihereve për Pranimin e Studentëve 2022-2023.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.10.2 Propozimi i Krihereve për Pranimin e Studentëve 2021-2022.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.10.3 Propozimi i Krihereve për Pranimin e Studentëve 2020-2021.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.11 Propozimi i Kuotave dhe Tarifave të Studimeve për Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i> https://www.ubt.edu.al/fea</p>
<p>Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të</p>	<p>Rregullorja e UBT për studime universitare, e cila mund të aksesohet nga të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të internetit të institucionit, specifikon të gjitha procedurat dhe kriteret e pranimit të studentëve bazuar në aktet ligjore dhe</p>

<p>studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>nënligjore në fuqi, dokumentacionin që i kërkohet studentit, kohëzgjatjen e studimeve, strukturën e programit të studimit, vlerësimin e dijeve të studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimit, kriteret e transferimit dhe diplomimit.</p> <p>Edhe rregullorja e programit të studimit në të cilën specifikohen në mënyrë më të detajuar këto procedura dhe kriteret, u vihet në dispozicion studentëve nga Departamenti i Financë-Kontabilitetit dhe ZKK dhe informacioni që përmban është lehtësisht i qartë dhe i kuptueshëm nga studentët dhe palët e interesuara.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>Përveç konsultimit të faqes së internetit, informimi mbi kriteret e pranimit në programin e studimit bëhet edhe nëpërmjet takimeve me studentë të vitit të tretë të ciklit të parë të studimeve, komunikimeve me e-mail dhe nëpërmjet telefonit, si edhe nëpërmjet afishimeve në stendat në ambjentet e UBT.</p> <p>Përzgjedhja e kandidatëve për studim në programin Master Profesional në Financë Bankë bëhet sipas kriterëve të meritës (notës mesatare të studimeve në bachelor) dhe kriterit të rëndësisë (llojit të profilit të studimeve bachelor) dhe renditja e kandidatëve bëhet sipas produktit të notës mesatare bachelor me koeficientin e profilit të studimeve në bachelor. Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta për programin e studimit janë të publikuara në faqen zyrtare të internet të institucionit dhe janë lehtësisht të aksesueshme nga publiku.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.10 Propozimi i Kriterëve për Pranimin e Studentëve 2023-2024.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.10.1 Propozimi i Kriterëve për Pranimin e Studentëve 2022-2023.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.10.2 Propozimi i Kriterëve për Pranimin e Studentëve 2021-2022.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.10.3 Propozimi i Kriterëve për Pranimin e Studentëve 2020-2021.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.11 Propozimi i Kuotave dhe Tarifave të Studimeve për Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p>
<p>Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e</p>	<p>Bazuar në RVB dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, GVJ konstaton se institucioni harton dhe publikon në fillim të çdo viti akademik procedurat e aplikimit për përzgjedhjen e kandidatëve të kategorive të veçanta (me status jetim, me aftësi</p>

<p>kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.</p>	<p>të kufizuara, komuniteti rom dhe egjiptian etj.). Këta kandidatë nuk aplikojnë nëpërmjet portalit e-Albania por direkt në UBT. Kriteret e veçanta përcaktohet nga FEA.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.11 Propozimi i Kuotave dhe Tarifave të Studimeve për Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p>		
<p>Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.</p>	<p>Bazuar në aktet rregullatore të UBT dhe FEA, GVJ konstaton se çdo vit akademik institucioni miraton dhe publikon edhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera, ku specifikohet se pranimiti i tyre bëhet në bazë të rregullore të UBT, FEA dhe programit të studimit.</p> <p><i>GVJ konstaton se nuk përcaktohen kritere specifike për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtetet e tjera.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 2.10 Propozimi i Kriteve për Pranimitin e Studentëve 2023-2024.pdf</i></p>		
<p>Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Në bazë të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 dhe VKM përkatëse, UBT harton dhe zbaton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.12 Dokumentacion për Studentët për Përfitim të Bursës për Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. 2.13 Dokumentacion për Studentët për Përfitim nga Tarifa për Vitin Akademik 2022-2023.pdf</i></p>		
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Politikat dhe procedurat që mbulojnë ciklin akademik të studentëve të programit të studimit “Master Profesional Financë Bankë” janë në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi dhe Statutin e UBT. - Kriteret dhe kuotat e pranimit, pas marrjes së miratimit sipas kuadrit rregullator, bëhen publike nga UBT përpara fillimit të aplikimeve për pranimitin në ciklin e dytë të studimeve. - Institucioni harton dhe zbaton politika të ndihmës/bursave për shtresat në nevojë dhe për studentët me rezultate të larta në studime. 		
<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p> <p style="text-align: center;">X</p>

Standardi V.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>UBT vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Ky informacion gjendet në rregulloren e brendshme të UBT (<i>neni 40, pika 11b</i>), rregulloren e FEA (<i>neni 44</i>), rregulloren e programit të studimit (<i>neni 12</i>).</p> <p><i>GVJ konstaton një mospërputhje midis rregulloreve: sipas rregullores se UBT nevojiten 25 kredite per kalimin e studentëve në vitin e dytë, ndërsa sipas rregulloreve të FEA dhe programit të studimit nevojiten 30 kredite.</i></p> <p><i>Për këtë qëllim GVJ rekomandon rishikimin e ketyre rregulloreve për unifikimin e këtij kriteri.</i></p> <p>Studentët vihen në dijeni mbi këto kritere dhe procedura edhe nga personeli akademik gjatë orës së parë të mësimin, kur bëhet prezantimi i lëndës.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.</p>	<p>Departamenti i Financë Kontabilitetit ofron mundësi për njohjen e krediteve dhe transferimin e studimeve midis programeve të të njëjtit cikël studimi, brenda UBT apo institucioneve të tjera të arsimit të lartë.</p> <p>Kriteret dhe procedurat e transferimeve dhe njohjes së studimeve bëhen të njohura nëpërmjet rregulloreve të institucionit, dhe veçanërisht për programin e studimit Master Profesional në Financë Bankë specifikohen në kreun VI të rregullores së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>

<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret dhe procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve në programin e studimit përcaktohen në të gjitha aktet rregullatore: rregulloren e UBT, të FEA dhe të Departamentit. Në veçanti kreu V i rregullores së programit të studimit përcakton që vlerësimi i studentëve të bëhet:</p> <ul style="list-style-type: none"> - nëpërmjet vlerësimit të vazhduar (ku përfshihen testimi indërmjetëm, detyrat e kontrollit, projektet e kursit) bëhet vlerësimi nga 30%-50% të vlerësimit total, dhe - nëpërmjet provimit përfundimtar. <p>Gjithashtu rregullorja specifikon edhe procedurat e organizimit të provimeve, sezonit të provimeve, ngritjen e komisioneve të provimeve, shpalljen e rezultateve, të drejtën e ankimimit dhe të përmirësimit të notës së provimit. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të vazhdueshëm dhe përfundimtar të dijeve specifikohet më hollësisht në programet e lëndëve.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i> <i>Evidencë nr. 3.5 Syllabuse.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>Kriteret e përgjithshme dhe procedurat që ndiqen lidhur me diplomimin e studentëve përcaktohen në rregulloren e UBT, të FEA dhe të programit të studimit. Në veçanti për programin e studimit Master Profesional në Financë Bankë, <i>neni 14</i> i rregullores së programit të studimit parashikon që studimet mbyllen me provim përfundimtar formimi ose me punim diplome për studentët që kanë një mesatare mbi 6.5, në përfundim të të cilit studentët pajisen me diplomë “Master Profesional në Financë Bankë”. Departamenti i Financë Kontabilitetit ndjek procedurat e përcaktuara në rregullore edhe kur Diploma mbrohet me provim formimi edhe kur mbrohet me punim.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për</p>	<p>GVJ konstaton se institucioni përpara fillimit të vitit akademik publikon në faqen zyrtare të internetit informacione udhëzuese dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit Master Profesional në “Financë Bankë”. Informimi realizohet nëpërmjet mjeteve të ndryshme të informimit si nëpërmjet takimeve me studentë të vitit të tretë të ciklit të parë të</p>

informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	studimeve, komunikimeve me e-mail dhe nëpërmjet telefonit, publikimeve në rrjetet sociale si edhe nëpërmjet afishimeve në stendat në ambjentet e UBT. <i>Vizita në Institucion</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> <ul style="list-style-type: none"> - UBT vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të tyre si dhe lidhur me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme në rast transferimi studimesh. - UBT vë në dispozicion të studentëve informacionin mbi kriteret e vlerësimit të dijeve në PS, përgatitjes dhe mbrojtjes së punimit të diplomës. - Intitucioni organizon aktivitete/takime informuese dhe publikon informacione për palët e interesuara për programin e studimit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit përmes faqes zyrtare të internetit të UBT, informacionit që marrin nga zyra e SKK, takimet me stafin akademik si dhe rregullores së programit të studimit. <i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet,	Studentët e programit të studimit Master Profesional Financë-Bankë, kanë mundësi të marrin informacion lidhur me modulet dhe përmbajtjen e programeve të studimit: <ul style="list-style-type: none"> • përmes faqes zyrtare online të institucionit dhe rregullores së programit të studimit; • përmes informimit nga zyra e ZSS;

<p>përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • përmes prezantimit nga stafi akademik të syllabuseve të lëndëve mësimore, të cilët përveç prezantimit tek studentët, i ngarkojnë edhe në websiten e tyre. Nëpërmjet syllabuseve studentët marrin informacione të detajuara mbi objektivat e lëndës, aftësitë dhe kompetencat e synuara, ngarkesën mësimore, temat për çdo javë mësimore, format e kontrollit dhe vlerësimit, kërkesat për frekuentimit të lëndës, si dhe literaturën bazë dhe të rekomanduar; • përmes afishimeve në mjediset e UBT. <p><i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i> <i>Evidencë nr. 3.5 Syllabuse.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.</p>	<p>Institucioni dhe në veçanti departamenti i Financë Kontabilitetit që është përgjegjës për këtë program studimi i mbështet studentët në orientimin e tyre drejt tregut të punës duke organizuar vazhdimisht takime me drejtues të institucioneve/bizneseve të ndryshme në vend.</p> <p>Brenda UBT është ngritur Qendra e Karrierës dhe Alumnit që ka për detyrë informimin dhe këshillimin e studentëve lidhur me mundësitë e punësimit dhe karrierën e tyre.</p> <p>Në këtë drejtim ndihmojnë edhe marrëveshjet që UBT ka lidhur me biznese dhe institucione publike për zhvillimin e praktikave profesionale të studentëve, të cilat ndihmojnë për një qasje sa më të mirë të studentëve me tregun e punës.</p> <p>Çdo vit, në mjediset e UBT zhvillohet Panairi i Karrierës, ku studentët kanë mundësi të kontaktojnë drejtpërdrejtë punëdhënësit potencial dhe të njihen konkretisht me kërkesat e tregut të punës.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.6.3 Raport i Panairit të Karrierës, qershor, 2022.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.22 Lista e marrëveshjeve 2022 .pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.6. Raport i Performancës së QKA 2019-2020.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe</p>	<p>Nëpërmjet takimeve që organizohen me Qendrën e Karrierës dhe Alumnit dhe përgjegjësin e Departamentit të Financë Kontabilitetit gjatë javës së parë të fillimit të vitit akademik, studentët informohen mbi zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Ky informacion është lehtësisht i aksesueshëm online dhe nëpërmjet standave dhe sinjalistikës orientuese brenda ambienteve të fakultetit.</p> <p>https://www.ubt.edu.al/fea</p>

shërbimet në funksion të realizimit të tij.									
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	<p>Institucioni përdor një sistem menaxhimi informacioni lehtësisht të aksesueshëm nga studentët, stafi akademik, ndihmës akademik dhe administrativ. Studentët pasi rregjistrohen në sekretarinë mësimore, krijojnë një llogari personale në sistemin elektronik të sekretarisë (sistemi Pitagora), ku pajisen me user name personal dhe password. Kjo llogari u mundëson studentëve të aksesojnë në distancë çdo informacion lidhur me frekuentimin dhe vlerësimin në çdo lëndë të programit të studimit.</p> <p>Çdo pedagog gjithashtu ka websiten e tij personal, në të cilin ngarkon syllabuset dhe materialet mësimore që lidhen me programin e lëndës, të cilat janë të aksesueshëm në distancë dhe në çdo kohë nga studentët e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.21 Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora.PDF</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UBT informon studentët mbi logjistikën, infrastrukturën e institucionit, strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. Informimi realizohet përmes takimeve, dokumentacionit, si dhe publikimit të informacionit në ambientet e institucionit dhe në faqen zyrtare të internetit.</i> - <i>Institucioni, nëpërmjet strukturave që ka ngritur, informon studentët mbi mundësitë e punësimit të tyre dhe zhvillon aktivitete në bashkëpunim me institucione dhe biznese për orientimin e tyre drejt tregut të punës.</i> - <i>Sistemi i menaxhimit të informacionit është funksional dhe lehtësisht i aksesueshëm në çdo kohë nga studentët dhe personeli akademik dhe administrativ.</i> 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve																
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.</p>	<p>Zyra e Informacionit dhe Statistikës, si degë e DZHKKVI (strukturë e ngritur në nivel institucioni) është përgjegjëse për rregjistrimin, ruajtjen dhe arkivimin e çdo të dhëne, dokumentacioni që lidhet me ecurinë e procesit mësimor të programit të studimit, përfshirë këtu edhe statistikat vjetore të të diplomuarve, në formë dokumentare dhe elektronike.</p> <p>GVJ gjatë vizitës në ambjentet e sekretarisë, verifikoi edhe rregjistrin e diplomave i cili mbante informacione me të dhëna për vitin e hyrjes, të mbarimit, numrin e diplomës, numrin e rregjistrimit, datën e lëshimit të diplomës dhe firmën e studentit. Në këtë program studimi deri në fund të vitit 2022 janë diplomuar 76 studentë.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.6 Rregullore DZHKKVI _DITNJ Final_V.2017 .pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>																
<p>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>UBT disponon statistika vjetore lidhur me numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të larguar nga programi i studimit.</p> <p>Tabela e mëposhtme përmban të dhëna për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi të raportuara nga dokumentet bashkëngjitur RVB dhe të siguruara gjatë verifikimit të rregjistrave që disponon sekretaria mësimore:</p> <table border="1" data-bbox="592 1171 1345 1473"> <thead> <tr> <th>Viti akademik</th> <th>Të regjistruar për herë të parë</th> <th>Të transferuar</th> <th>Totali</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td>2022-2023</td> <td>29 studentë</td> <td>1 studentë</td> <td>30 studentë</td> </tr> <tr> <td>2021-2022</td> <td>44 studentë</td> <td>0 studentë</td> <td>44 studentë</td> </tr> <tr> <td>2020-2021</td> <td>29 studentë</td> <td>1 studentë</td> <td>30 studentë</td> </tr> </tbody> </table> <p>Gjatë vizitës në ambjentet e SKK, GVJ verifikoi se numri i studentëve të regjistruar dhe transferuar përputhej me numrin e studentëve të paraqitur në tabelat bashkëngjitur RVB.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>	Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali	2022-2023	29 studentë	1 studentë	30 studentë	2021-2022	44 studentë	0 studentë	44 studentë	2020-2021	29 studentë	1 studentë	30 studentë
Viti akademik	Të regjistruar për herë të parë	Të transferuar	Totali														
2022-2023	29 studentë	1 studentë	30 studentë														
2021-2022	44 studentë	0 studentë	44 studentë														
2020-2021	29 studentë	1 studentë	30 studentë														
<p>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të</p>	<p>Institucioni përdor sistemin e menaxhimit të informacionit Pitagora, në të cilin rregjistrohen në formatin elektronik të dhënat statistikore mbi ecurinë dhe vlerësimin e studentëve, të cilat janë të aksesueshme në çdo kohë nga personat e autorizuar.</p>																

<p>informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Të dhënat në këtë sistem janë të sigurta, të aksesueshme vetëm nga persona të autorizuar dhe ruhen për një kohë të gjatë.</p> <p>Gjatë vizitës në ambjentet e sekretarisë, GVJ konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve ruhen edhe në formatin hard copy nga ZSS (si proceverbale, listë notash, rregjistrin themeltar, rregjistrin e arritjeve akademike etj).</p> <p><i>Evidencë nr. 1.21 Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora.PDF</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.</p>	<p>Veprimtaria e ZIS dhe ZSS rregullohet me rregulloren e DZHKKVI (në organigramën e re e emërtuar Drejtoria e Shërbimeve Mësimore dhe Studentëve - DSHMS) si pjesë të organikës së saj, e cila ushtron veprimtarinë në përputhje me Ligjin “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, rregulloret e studimeve universitare, urdhrat dhe udhëzimet në fuqi. DSHMS (ish DZHKKVI) në bashkëpunim me zëvendësrektorin për mësimin, harton çdo vit analizën mësimore të universitetit dhe ia paraqet për shqyrtim Senatit Akademik.</p> <p><i>Megjithatë GVJ nuk konstatoi ndonjë dokument apo raportim periodik mbi vlerësimin e veprimtarisë së njësive që merren me menaxhimin e informacionit.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 1.6 Rregullore DZHKKVI _DITNJ Final_V.2017 .pdf</i> <i>Vizita në institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>Institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve bazuar tek të dhënat që grumbullojnë dhe përpunojnë Zyra e Informacionit dhe Statistikës në bashkëpunim me Zyrën e Studimeve dhe Studentëve.</p> <p>Këto të dhëna përfshijnë regjistrimet/aplikimet për vijimin e studimeve në programe të ndryshme të studimit, mesataren e aplikantëve të regjistruar, rezultatet sipas programeve të studimit, studentët e transferuar, evidenca lidhur me studentët e diplomuar, etj. GVJ u informua se Departamenti i Financë Kontabilitetit është në kontakt të vazhdueshëm me Qendrën e Karrierës dhe Alumnit e cila ka për detyrë gjurmimin e studentëve në tregun e punës dhe hartimin e raporteve lidhur me ecurinë e studentëve në tregun e punës, mbas diplomimit të tyre.</p>

	<p>Evidencë nr. Dokumente shtese - Analiza e punës Mësimore-Kërkimore Dep FK 2021-2022</p> <p>Evidencë nr. Dokumente shtese - Analiza mësimore e vitit akademik 2021-2022</p> <p>Vizita në Institucion</p>			
Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT mban dhe disponon statistika të rregullta vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar, të transferuar dhe të diplomuar në këtë program studimi. - Departamenti mban statistika mbi numrin dhe cilësinë e studentëve të përfshirë në programin e studimit, dhe bën një analizë të problemeve dhe masave të nevojshme për përmirësimin e situatës. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
<p>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.</p>	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.</p>	<p>Përfshirja dhe angazhimi i studentëve apo përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse dhe këshilluese garantohet nga Statuti i UBT, sipas të cilit studentët janë pjesë e strukturave të mëposhtme drejtuese dhe këshilluese:</p> <ul style="list-style-type: none"> • Senati i UBT, në të cilin nga 25 anëtarë gjithsej, tre janë studentë; • Komisionet e Përhershme, si Komisioni i Sigurimit të Cilësisë, Programit të Studimit dhe Kërkimit Shkencor i cili ka në përbërje një student; • Studentët kanë të drejtën e zgjedhjes së një figure publike në Bordin e Administrimit të UBT; • Studentët organizohen në Këshillat e Studentëve të cilët zhvillojnë dhe promovojnë aktivitetet studentore dhe koordinojnë punën për zgjedhjen e përfaqësuesve të studentëve në organet drejtuese të institucionit.

	<i>Evidencë nr. 1.1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i>
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.	<p>Studentët japin drejtpërdrejtë kontributin e tyre nëpërmjet përfshirjes në organet e vendimmarrjes si Senati apo komisionet e përhershme dhe strukturat këshilluese si Këshilli i Studentëve, të garantuara nga statuti dhe rregullorja e brendshme e UBT.</p> <p>Nëpërmjet këtyre strukturave, takimeve me stafin akademik, përfshirjes në organizimin e aktiviteteve të ndryshme si Panairi i Punës apo pjesëmarrjes në aktivitetet e promovimit të programeve të studimit, studentët shprehin opinione dhe propozime për të gjitha problemet që lidhen me procesin mësimor dhe jetën studentore.</p> <p>Me nxitjen e strukturave të institucionit, Këshilli i Studentëve organizon edhe veprimtari të ndryshme sportive dhe kulturore jashtë-shkollore.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.6. Raport i Performancës së QKA 2019-2020.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.6.3 Raport i Panairit të Karrierës, qershor, 2022.pdf</i></p>
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	<p>Përveç diskutimeve midis studentëve dhe pedagogëve gjatë zhvillimit të procesit mësimor, nëpërmjet të cilëve pedagogu merr drejtpërdrejt informacion nga studentët mbi realizimin e pritshmërive dhe objektivave të programit të studimit dhe përmirësimin e tij, çdo fund semestri studentët plotësojnë edhe pyetësorët mbi cilësinë e mësimdhënies, nëpërmjet të cilëve studentët kanë mundësi të shprehin sugjerime lidhur me përmirësimin e programeve të studimit. Pasi pyetësorët përpunohen, rezultatet e tyre bëhen pjesë e analizës së punës mësimore dhe kërkimore në departament dhe më gjerë.</p> <p><i>Evidencë nr. 6.4 Format Pyetësori për Vlerësimin e Procesit Mësimor.pdf</i></p>
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/	<p>Rregulloret e institucionit dhe njësisë kryesore, dhe në veçanti rregullorja e programit të studimit parashikojnë në detaje procedurën e vlerësimit të studentëve, të drejtën e ankimimit të rezultatit të provimeve dhe mundësinë e rishikimit të rezultatit, duke u dhënë siguri studentëve për barazi dhe paanshmëri në vlerësimin e njohurive të tyre.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>

njësisë/pedagogut përgjegjës.									
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - UBT nëpërmjet akteve rregullatore në përputhje me legjislacionin në fuqi, ka mundësuar konkretisht përfaqësimin e studentëve në Senatin Akademik, në Komisionet e Përhershme, dhe në GVB si dhe orgaizimin e tyre në Këshilla Studentorë. - GVJ konstatoi se departamenti merr në konsideratë opinionet e studentëve mbi përmirësimin e programit të studimit nëpërmjet mbledhjeve/takimeve periodike dhe pyetësorëve. - Institucioni nëpërmjet rregulloreve përkatëse garanton barazinë e studentëve në procesin e vlerësimit dhe kontrollit të dijeve. 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi V.6	
Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	<p>Bazuar në parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit, UBT ka ngritur Degën e Zhvillimit të Kurrikulave, Karrierës dhe Vlerësimit Institucional (në organigramën e re e emërtuar Drejtoria e Shërbimeve Mësimore dhe Studentëve - DSHMS) e cila ka në varësi disa sektorë, si ZSS dhe QKA, që janë në shërbim të këshillimit dhe informimit të studentëve të UBT. Gjithashtu edhe Departamenti i Financë-Kontabilitetit si njësi bazë përgjegjëse e programit të studimit është në shërbim të studentëve për çdo informacion që lidhet me veprimtarinë mësimore të tyre.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.6 Rregullore DZHKKVI _DITNJ Final_V.2017 .pdf</i></p>

<p>Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>Në organikën e DZHKKV (në organigramën e re e emërtuar Drejtoria e Shërbimeve Mësimore dhe Studentëve) janë ngritur disa zyra që janë në shërbim të studentëve, si:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Zyra e Studimeve dhe Studentëve (ZSS) e cila ndër të tjera është përgjegjëse për regjistrimin dhe mbajtjen e bazës së të dhënave të studentëve, mbajtjen dhe përditësimin e dokumentacionit lidhur me ecurinë mësimore dhe diplomimin e tyre, përgatitjen dhe dhënien e vërtetimeve e konfirmimeve përkatëse, etj. - Qendra e Karrierës dhe Alumnit (QKA), e cila sipas nenit 41 të rregullores së DZHKKV, ka për funksion sigurimin e informacioneve dhe ofrimin e zgjidhjeve për çështjet që lidhen me zhvillimin e karrierës së studentëve duke shërbyer si një urë ndërlidhëse midis studentëve të UBT dhe tregut të punës. <p><i>Evidencë nr. 1.6 Rregullore DZHKKVI _DITNJ Final_V.2017 .pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.6. Raport i Performancës së QKA 2019-2020.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>Gjatë takimit me përfaqësues të Sektorit të Karrierës dhe Alumnit, GVJ iu konfirmua se QKA dhe ZKS ofrojnë shërbime lidhur me promovimin e programeve të studimit që ofrohen nga institucioni për të tërhequr studentë sa më cilësorë, këshillimin e karrierës (lidhur me mënyrën e aplikimit për punë, hartimit të CV-së dhe letrës së motivimit), organizimin e Panairit të Karrierës dhe rrjetit për internshipe dhe punësim, anëtarësimin në rrjetin ALUMNI, tërheqjen e opinioneve të studentëve alumni mbi programet e studimit dhe pëputhshmërinë e tyre me kërkesat e tregut të punës etj.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.6 Rregullore DZHKKVI _DITNJ Final_V.2017 .pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion</p>	<p>Gjatë vizitës në institucion GVJ u informua se UBT në bashkëpunim me Qendrën Karrierës dhe Alumnit realizojnë gjurmimin e studentëve të programit të studimit në tregun e punës, duke realizuar një pyetsor online.</p> <p>Të dhënat analizohen nga QKA me qëllimin për të nxjerë në pah kryesisht vlefshmërinë e diplomës së UBT në treg, dhe punësimin e studentëve.</p>

<p>studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p><i>GVJ konstaton se kjo analizë bëhet në nivel institucioni dhe në bazë të dokumentacionit shoqërues të RVB nuk ka ndonjë informacion specifik për studentët e programit të studimit Master Profesional në Financë Bankë.</i></p> <p>UBT është bërë pjesë e projektit GRADUA, i financuar nga Programi Erasmus+ i Bashkimit Evropian, i cili ka për qëllim të krijojë një sinergji të fortë midis universitetit dhe tregut të punës, për vlerësimin e performancës së sistemit arsimor si dhe sigurimin e mjeteve inovative të rekrutimit. GVJ konstaton se edhe në raportin e Gradua-s informacioni ofrohet deri në nivel njësie kryesore.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.15 Raporti GRADUA.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.6. Raport i Performancës së QKA 2019-2020.pdf</i></p>
--	--

<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>UBT ka krijuar procedura dhe ka ngritur struktura të posaçme (ZSS dhe QKA) për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.</i> - <i>QKA mbledh të dhëna për të diplomuarit përmes pyetësorëve online për gjurmin e studentëve. Të dhënat mbi punësimin e studentëve raportohen në shkallë njësie kryesore dhe jo për program studimi.</i>
---------------------------	--

<p>Shkalla e përmbushjes së standardit</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

<p>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V</p>	<p>Niveli i përmbushjes</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p>X</p>

VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

<p>Standardi VI.1</p>

Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.</p>	<p>Rregullorja e UBT (<i>Neni 50</i>) dhe FEA (<i>Neni 57</i>) specifikojnë forma të ndryshme të mësimdhënies, mësimnxënies dhe të kontrollit të dijeve të cilat specifikohen në planet mësimore, programet e lëndëve dhe në rregulloren e programit të studimit (<i>Neni 23</i>). Rregulloret parashikojnë përdorimin e formave të ndryshme teorike dhe praktike të mësimi si leksionet, seminarët, ushtrimet, praktikat profesionale, punët laboratorike, detyrat e projektet e kursit etj.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion GVJ konstatoi se aplikimi i metodave të ndryshme gjatë mësimdhënies, si rastet studimore, analizat në grupe dhe punë individuale, debatet dhe shkëmbimi i ideve, përdorimi i literaturës shtesë ndihmon studentët që nëpërmjet formave interaktive të komunikimit të përvetësojnë më mirë materialin mësimor në aspektin teorik dhe praktik.</p> <p>Gjatë vizitës në institucion dhe bazuar edhe në dokumentacionin bashkengjitur RVB, GVJ konstaton se institucioni angazhohet vazhdimisht në zhvillimin e mekanizmave dhe metodave inovative të mësimdhënies në ndihmë të procesit mësimor.</p> <p>Institucioni ka përdorur vazhdimisht disa sisteme menaxhimi informacioni si më poshtë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - “Google class” – me atë të së cilës pedagogët krijojnë një llogari të tyre ku ngarkojnë materialet mësimore si leksionet në poëer point, detyra kursi, ushtrime, planin kalendarik, literaturën e rekomanduar etj. të aksesueshëm lehtësisht nga studentët; - “Esse” i zëvendësuar aktualisht me “Pitagora” – nëpërmjet të cilit studentët informohen nga pedagogët lidhur me vlerësimin e vazhdueshëm dhe përfundimtar të tyre. - “TEEAL” – një bibliotekë online, ku pedagogët mund të aksesojnë tekste, revista dhe artikuj të ndryshëm shkencorë. <p>Stafi akademik kryen trajnime për përdorimin e këtyre sistemeve dhe manualët e përdorimit të tyre vihen në dispozicion të stafit akademik. Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB, UBT</p>


	<p>ka vënë në zbatim sistemin e menaxhimit Pitagora për aksesimin e informacionit nga studentët.</p> <p>Gjatë periudhës së pandemisë për procesin e mësimdhënies janë përdorur platforma të ndryshme on-line si Teams, Google Classroom etj.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.21 Manual Përdorimi për Sistemin Pitagora.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik.</p>	<p>Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p> <p>Politika e sigurimit të cilësisë në UBT është bazuar në Ligjin Nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionët e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në Statutin e UBT-së dhe rregulloret përkatëse. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar dhe zyrtarizuar në Planin Strategjik të UBT 2016-2025.</p> <p>Bazuar në strategjinë e institucionit, sistemi i sigurimit të cilësisë merr në konsideratë kontrollin që ndjek veprimtarinë e universitetit përmes vlerësimit të brendshëm ku përfshihen disa mekanizma si: vetë-analiza, kontrole rutinë në auditorë, vlerësimi i stafit nga përgjegjësi i departamentit, vlerësimin e pedagogëve nga ana e studentëve; vlerësimin e programeve mësimore, vlerësimin e pjesëmarrjes në veprimtarinë kërkimore, vlerësimin në zhvillimin e aktiviteteve nacionale, rajonale dhe më gjerë etj.</p> <p>Në nivel institucioni është ngritur Drejtoria e Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë (në organigramën e re ka emërtimin Drejtoria e Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë), e cila ndjek procedurat, aktivitetet dhe verifikon dokumentacionin për vlerësimin e programeve të studimit në nivel institucioni, si dhe vlerësimin e brendshëm në lidhje me akreditimin institucional dhe të programeve të studimit dhe sigurimit të cilësisë së tyre. Në nivel Fakulteti është ngritur edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.</p> <p><i>Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe gjatë takimit me përfaqësues të sektorit të sigurimit të cilësisë, GVJ konstaton se nuk ka ndarje të qartë të detyrave midis DVBS, NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 1.2 Plani Strategjik UBT 2016-2025.pdf</i></p>

	<i>Evidencë nr. 1.7 Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.pdf</i>
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve.	<p>Studentët përfshihen drejtpërdrejt në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve mëpërmjet mbledhjeve/takimeve me përgjegjës të departamentit dhe nëpërmjet plotësimit të pyetësorëve në fund të çdo semestri. Në pyetësor, studentët pyeten në lidhje me: kushtet e mësimin, korrektësinë e personelit, cilësinë dhe qartësinë e prezantimit të leksioneve e seminareve si dhe inkurajohen të sugjerojnë ndonjë përmirësim të aktivitetit mësimdhënies.</p> <p>E drejta e ankimimit përcaktohet në të gjitha rregulloret e institucionit, përfshirë edhe rregulloren e programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.19 Pyetësi On -Line i Studentëve UBT, 2018-2019. pdf</i></p>
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit, GVJ konstatoi se rezultatet e vlerësimit të kryer nga strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë bëhen objekt diskutimi në analizën vjetore të Departamentit të Financë Kontabilitetit, e cila përfshihet në analizën e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore të FEA dhe UBT. GVJ konstaton se në këto raporte përfshihen rezultatet e vlerësimit dhe parashikohen masat që duhet të ndërmerren për adresimin e mangësive dhe problematikave të ndeshura më qëllim përmirësimin e procesit të mësimdhënies.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.3 Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore UBT 2019-2020.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.4 Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore, FEA, 2019-2020.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.5. Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore dhe Marrëdhëniet me Publikun dhe Institucionet 2021-2022 .pdf</i></p>
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmeve të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	<p>Gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi gadishmërinë e drejtuesve të institucionit për të promovuar personelin akademik dhe për të asistuar në drejtim të kualifikimit të mëtejshëm nëpërmjet ofrimit të trajnimeve brenda dhe jashtë vendit dhe pjesëmarrjes në konferenca dhe projekte të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.16 Pjesëmarrja e Stafit në Projekte brenda dhe jashtë vendit (2015-2021).pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.17 Trajnimet e Stafit të Brendshëm 2015-2021, FEA.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>

Konkluzione	<p>GVJ konstaton se:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Institucioni ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies; - UBT ka hartuar udhëzues të posaçëm dhe ka vënë në funksion metoda inovative të zhvillimit të mësimin. - Studentët përfshihen në procesin e vlerësimit të metodave të mësimdhënies. - Rezultatet e vlerësimit bëhen pjesë e analizave dhe përfshihen në raportet vjetore të institucionit. 			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.2	
Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	<p>Në bazë të statutit të institucionit (<i>Neni 83</i>) institucioni ka hartuar politika dhe struktura të posaçme për sigurimin e brendshëm të cilësisë në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p> <p>Rrjeti i sigurimit të cilësisë sigurohet nga DVBSK (në organigramën e re ka emërtimin Drejtoria e Programeve dhe Sigurimit të Cilësisë – DPSC) e ngritur në nivel institucioni dhe Njësitë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e ngritur në nivel njësisie kryesore. Gjithashtu në bazë të ligjit për arsimin e lartë është ngritur edhe Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, Programeve të studimit dhe Kërkimit Shkencor, i cili funksionon si një organi kolegjal.</p> <p><i>Evidencë nr. 1. 1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i></p>
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe	DPSC harton standartet institucionale të cilësisë bazuar në Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, të cilat miratohet nga Senati Akademik. Funksionet e DPSC (ish DVBSK) përcaktohen statutin e UBT (<i>neni 84</i>) dhe në rregulloren e saj.

<p>zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>Rregullorja e studimeve të UBT (<i>neni 91</i>) dhe rregullorja e FEA (<i>neni 91</i>) parashikon ngritjen e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, e cila ka për detyrë të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe të vlerësojë periodikisht rezultatet e veprimtarisë kërkimore-shkencore.</p> <p><i>GVJ sugjeron që edhe NJSBC të ketë një rregullore të saj në mënyrë që të ketë një specifikim më të qartë të përgjegjësisë dhe detyrave të saj dhe mos ketë mbivendosje të tyre me DPSC. Në kuadër të ndërtimit të organigramës së re, rekomandohet rishikimi i rregulloreve të strukturave që kanë ndryshuar emërtim.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.7 Rregullore e Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë.pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.</p>	<p>UBT është akredituar për herë të dytë me vendim të Bordit të Akreditimit nr. 59, datë 16.12.2021 me vlerësim pozitiv dhe kohëzgjatje 5 vite.</p> <p>Program i studimit Master Profesional në Financë Bankë po i nënshtrohet për herë të parë procesit të akreditimit.</p> <p><i>Evidencë nr. 4.1 Akreditimi _Vendimi Nr. 59 _ date 16.12.2021.pdf</i></p>
<p>Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe nga vizita në institucion, GVJ konstatoi disa instrumente të vlerësimit të cilësisë në mësimdhënie si pyetësorët e studentëve dhe vizita në auditorë, veçanërisht për stafin e ri akademik, rezultatet e të cilëve bëhen objekt diskutimi i analizës vjetore të Departamentit të Financë Kontabilitetit.</p>



mira në programin e studimit.									
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni në bazë të parashikimeve ligjore dhe akteve rregullatore ka ngritur dhe ka në funksion strukturat për sigurimin e brendshëm të cilësisë në nivel institucioni dhe njësie kryesore, përkatësisht DVBC dhe NJSBC, por konstaton që nuk ka një ndarje të qartë të detyrave dhe përgjegjësi midis tyre.</i> - <i>Aktet rregullatore përcaktojnë procedurat dhe instrumentet e sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i> 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th>Plotësisht</th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td>X</td> <td></td> </tr> </tbody> </table>	Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht			X	
Plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
		X							

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim.</p> <p>Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen</p>	<p>Sipas parashikimeve në Ligjin për Arsimin e lartë, rregullorja e brendshme e intitucionit (<i>Neni 18</i>) dhe rregullorja e brendshme e FEA (<i>Neni 18</i>) përcakton procedurat qe ndiqen për hapjen e një program të ri studimi apo riorganizimin e programeve të studimeve me ndryshime deri në masën 20%.</p> <p>Programi i studimit Master Professional në Financë Bankë është duke u akredituar për herë të pare dhe nuk është bërë ndonjë ndryshim në përmbajtjen e planit mësimor që nga momenti i licensimit të tij.</p> <p>Neni 93 i rregullores së FEA përcakton procedurën që ndjek Fakulteti në fund të çdo viti akademik për rishikimin periodik të programit të studimit duke specifikuar edhe elementët të cilëve duhet ti kushtohet vëmendje gjatë procesit të rishikimit. Në këtë proces përfshihen edhe studentët nëpërmjet marrjes së opinionëve të tyre lidhur me zhvillimin e procesit mësimor.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i></p>

<p>dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.</p>	<p><i>Evidencë nr. 1.4 Rregullore e Brendshme e FEA, 2017.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.5 Rregullore e Programit të Ckilit të Dytë të Studimeve MPFB.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqërues të RVB dhe gjatë vizitës në institucion GVJ iu komunikua se në fund të vitit akademik, gjatë analizës vjetore të departamentit, Departamenti i Financë-Kontabilitetit merr në shqyrtim problematikat që kanë dalë dhe sugjerimet lidhur me përmirësimin e programeve të studimit. Lidhur me programin e studimit Master Professional Financë Bankë ndryshime janë bërë vetëm në drejtim të pasurimit me raste studimore apo të literaturës së rekomanduar.</p> <p>Analiza e veprimtarisë mësimore kërkimore eidenton dobësitë dhe mangësitë që rezultojnë në përgjithësi për programet e studimit të FEA dhe përmban rekomandime për përmirësimin e tyre.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.3 Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore UBT 2019-2020.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.4 Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore, FEA, 2019-2020.pdf</i> <i>Evidencë nr. 2.5. Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Institucionet 2021-2022 .pdf</i></p>
<p>Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstucionale apo kombëtare, si: provimi i</p>	<p>Bazuar në rregulloret e brendshme të institucionit dhe nga vizita në institucion, GVJ konstaton se institucioni përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë së programit të studimit si: vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim i didaktikës, kurrikulës, infrastrukturës në shërbim të procesit mësimor, vlerësime të detyrave dhe projekteve të kursit të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë zhvillimit të procesit mësimor etj. Ky vlerësim realizohet nëpërmjet instrumenteve të drejtpërdrejta dhe të tërthortë si të pyetësorëve, vëzhgimeve në auditor, pjesëmarrjes së pedagogëve të rinj në leksione të profesorëve me eksperiencë, takimeve formale dhe jo formale me student të programit të studimit.</p> <p><i>GVJ konstaton që përveç pyetësorëve nuk ka dokumenta vërtetues apo procesverbale që të eidentojnë zhvillimin e këtyre takimeve apo vizitave në auditor.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 1.19 Pyetësi On -Line i Studentëve UBT, 2018-2019. pdf</i></p>

shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.									
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	<p>Në kuadër të vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit, institucioni realizon sondazhe të studentëve nëpërmjet pyetësorëve që plotësohen në fund të çdo semestri akademik nga studentët aktualë si dhe gjurmimin e studentëve të diplomuar nëpërmjet pyetësorëve ose intervistave që zhvillohen gjatë panairit të punës. Programi Gradua është përdorur me sukses nga UBT, por informacioni që merret nga ky program është në nivel Fakulteti dhe jo në program studimi.</p> <p><i>GVJ sugjeron që vlerësimi të bëhet individualisht për çdo program studimi në mënyrë që të nxirren përfundime konkrete dhe specifike për programin e studimit.</i></p> <p><i>GVJ rekomandon që institucioni duhet ti formalizojë këto instrumenta të vlerësimit të cilësisë dhe ti zgjerojë duke marrë në konsideratë jo vetëm opinionet e studentëve, por edhe të personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe të bashkëpunëtorëve të jashtëm.</i></p> <p><i>Evidencë nr. 1.15 Raporti GRADUA.pdf</i></p>								
Konkluzione	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Institucioni monitoron dhe vlerëson përmes strukturave të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</i> - <i>GVJ konstaton se rezultatet e vlerësimeve bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe merren në konsideratë për adresimin e problematikave të evidentuara, planin e masave për përmirësim dhe motivimin e praktikave më të mira.</i> 								
Shkalla e përmbushjes së standardit	<table border="1"> <thead> <tr> <th></th> <th>Përmbushet pjesërisht</th> <th>Përmbushet kryesisht</th> <th>Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td>X</td> </tr> </tbody> </table>		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				X
	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			X						

Standardi VI.4

Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p>Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>UBT ka ngritur struktura në nivel instiucioni dhe njësie kryesore të cilat kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë duke përfshirë personelin e brendshëm akademik dhe adminsitrativ, studentët si dhe aktorë të jashtëm si lektorë të ftuar apo bashkëpunëtorë në projekte të ndryshme, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.1 Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i> <i>Evidencë nr. 1.16 Manuali cilësisë UBT.pdf</i></p>
<p>Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Manuali i sigurimit të cilësisë përcakton strukturat përgjegjëse për vlerësimin dhe sigurimin e brendshëm të cilësisë të programit të studimit si dhe të gjitha organet, duke specifikuar detyrat dhe përgjegjësitë për secilin prej tyre.</p> <p>I gjithë personeli akademik dhe administrativ ka rol të rëndësishëm në menaxhimin dhe zbatimin e procedurave të sigurimit të cilësisë përmes një bashkëpunimi të vazhdueshëm me strukturat e sigurimit të cilësisë. Senati si organi më i lartë akademik ka përgjegjësinë përfundimtare për miratimin, monitorimin dhe rishikimin e të gjitha procedurave të sigurimit të cilësisë. GVJ konstaton se studentët nuk janë të përfaqësuar në NJSBC të FEA, ndërsa një student është anëtar i GVB i programit të studimit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.16 Manuali cilësisë UBT.pdf</i> <i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i></p>
<p>Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe</p>	<p>FEA ka ngritur Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e cila ka për detyrë të monitorojë në mënyrë të vazhdueshme dhe vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarisë mësimore dhe kërkimore-shkencore. Njësia e Brendshme e Sigurimit të Cilësisë përbëhet nga 3 anëtarë.</p> <p><i>GVJ konstaton se nuk ka në përberje e saj përfaqësues të Departamentit të Financë Kontabilitetit, si njësia bazë përgjegjëse e këtij program studimi dhe rekomandon ristrukturimin e kësaj njësie me përfaqësues nga çdo department.</i></p>

<p>studentëve të programit të studimit.</p>	<p>GVB të programit të studimit përbëhet nga pesë anëtarë: tre staf akademik i departamentit të Financë Kontabilitetit, një staf administrativ dhe një student.</p> <p><i>Evidencë nr. 5. Aneks_Tabelat Përmbledhëse Financë Banke.PDF</i></p>
<p>Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>Bazuar në dokumentacionin shoqëruar të RVB dhe gjatë takimit me drejtuesit e institucionit dhe stafin akademik përgjegjës të programit të studimit, GVJ konstatoi se personeli akademik përfshihet në mënyrë aktive në proceset e vlerësimit të programeve të studimit, duke respektuar të drejtat dhe integritetin akademik të secilit prej tyre dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.14 Kodi i Etikës së UBT.pdf</i> <i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Kriteri 5. Pjesë 93roces e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vjera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.</p>	<p>Institucioni ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me aktorë biznesi dhe institucione publike dhe private të cilat mundësojnë realizimin e leksioneve të hapura me lektorë të ftuar, pjesëmarrjen e bizneseve të ndryshëm në panairt e punës, si dhe realizimin e praktikave profesionale të studentëve.</p> <p>Nëpërmjet këtyre bashkëpunimeve, përfaqësues të biznesit apo institucioneve të tjera arsimore brenda dhe jashtë vendit, japin mendimet e tyre lidhur me cilësinë e programit të studimit dhe përmirësimin e tij.</p> <p>GVJ konstaton se strukturat e ngritura për sigurimin e brendshëm të cilësisë nuk kanë në përbërjen e tyre ekspert të jashtëm.</p> <p><i>Vizita në Institucion</i></p>
<p>Konkluzione</p>	<p><i>GVJ konstaton se:</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - <i>Aktet rregullatore lidhur me sigurimin e brendshëm të cilësisë të UBT, përcaktojnë qartë strukturat dhe njësitë që angazhohen në këtë proces.</i> - <i>UBT siguron përfshirjen dhe aktivizimin e personelit akademik dhe të studentëve në proceset e vlerësimit dhe sigurimit të cilësisë së programit të studimit, por konstaton se NJSBC nuk ka përfqësues të studentëve dhe të njësisë bazë përgjegjëse të programit të studimit.</i> - <i>Përfshirja e bashkëpunëtorëve dhe/ose ekspertëve të jashtëm bëhet nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme që organizohen nga institucioni, por ato nuk janë pjesë e strukturave formale të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</i>


Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	<p>Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përcaktohen në aktet rregullatore të institucionit si Statuti i UBT, plani strategjik dhe rregullorja e studimeve universitare të UBT, për të cilat studentët informohen vazhdimisht nga personeli akademik dhe strukturat e UNT. Rregullorja e studimeve universitare është lehtësisht e aksesueshëm nga studentët dhe nga të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare të internetit të institucionit.</p> <p><i>Evidencë nr. 1.1. Statuti i UBT miratuar sipas Urdhërit nr 279 dt. 28 Korrik 2021.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. 1.3 Rregullore e studimeve universitare.pdf</i></p> <p>https://www.ubt.edu.al/fea</p>
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	<p>Rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit analizohen gjatë analizave vjetore në Departamentin e Financë Kontabilitetit dhe bëhen pjesë e Analizës së Veprimtarive Mësimore dhe Kërkimore të FEA, si dhe sipas akteve rregullatore përfshihen në raportet periodike të Drejtorisë së Vlerësimit të Brendshëm dhe Sigurimit të Cilësisë në nivel rektorati. Gjatë vizitës në institucion GVJ konstaton se këto raporte/analiza respektojnë lirinë dhe etikën akademike si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p> <p><i>Evidencë nr. 2.3 Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore UBT 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. 2.4 Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore, FEA, 2019-2020.pdf</i></p> <p><i>Evidencë nr. 2.5. Analiza e Veprimtarisë Mësimore Kërkimore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Institucionet 2021-2022 .pdf</i></p> <p><i>Evidenca shitesë - Analiza e punës Mësimore-Kërkimore Dep FK 2021-2022</i></p> <p><i>Evidenca shitesë - Analiza mësimore e vitit akademik 2021-2022</i></p>
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të	GVJ konstaton se në bazë të rezultateve të vlerësimit dhe analizës vjetore që bëhet çdo fund viti në department, dekanati i FEA

shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	harton një plan veprimi i cili specifikon aktivitetin apo problematikën që kërkohet të zgjidhet, indikatorët dhe afatin e realizimit të tyre, strukturën përgjegjëse për kryerjen e tij dhe personin mbikqyrës. <i>Evidencë nr. 1.2.2 Plan Veprimi për Vitin Akademik 2022-2023 .pdf</i>			
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	Gjatë vizitës në insitucion GVJ iu konfirmua nga drejtuesit e njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse të programit të studimit, në bazë të problematikave dhe ndryshimeve të kërkesave të tregut, angazhohen që të përmirësojnë programin e studimit në kuadër të monitorimit dhe sigurimit të cilësisë. GVJ mori konfirmimin se program i studimit është ndryshuar në drejtim të përmirësimit të literaturës së rekomanduar, përditësimin e materialeve në power-point të përgatitur nga stafi akademik, por pa ndryshuar përmbajtjen e programit të studimit. <i>Vizita në Institucion</i>			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	Referuar dokumentacionit në dispozicion, UBT harton çdo vit raportin mbi cilësinë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, i cili u vihet në dispozicion stafit akademik dhe administrativ. Gjithashtu drejtuesit e institucionit dhe strukturave përgjegjëse zhvillojnë vazhdimisht takime me personelin akademik për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. <i>Evidenca shtesë - Analiza e punës Mësimore-Kërkimore Dep FK 2021-2022</i> <i>Evidenca shtesë - Analiza mësimore e vitit akademik 2021-2022</i>			
Konkluzione	<i>GVJ konstaton se:</i> - <i>Strategjia, politikat dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe të aksesueshme nga studentët dhe palët e interesuara.</i> - <i>Rezultatet e vlerësimit analizohen në mbledhje periodike në nivel njësie bazë, kryesore dhe në nivel institucioni, në bazë të të cilëve institucini harton një plan masash për përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programti të studimit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X



Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë

Master Profesional në “Financë Bankë”

a. Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit ofrohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit dhe është në përshtatje dhe në zbatim qëllimit dhe misionit të institucionit, si dhe në përcaktimet ligjore;
2. Kurrikul bashkëkohore në përputhje me objektivat formuese të programit të ciklit të dytë;
3. Nivel i lartë kualifikimi kërkimor-shkencor dhe angazhimi i personelit akademik të programit të studimit në drejtim të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, përmirësimit të kurrikulave dhe përdorimit të metodave inovative gjatë procesit mësimor;
4. Marrëveshje të shumta bashkëpunimi me njësi biznesi, institucione të arsimit të lartë dhe me institucione të tjera publike dhe private për të realizuar objektivat studimore si në procesin e mësimin, aktivitetin kërkimor-shkencor, si edhe në realizimin e praktikave mësimore;
5. Mjediset e përshtatshme dhe infrastruktura didaktike moderne në dispozicion të programit të studimit ofron hapësirat dhe kushtet e nevojshme bashkëkohore për procesin mësimor;
6. Përdorim i literaturës bashkëkohore, në përputhje me programin e studimit, fizike dhe në platformat on-line;
7. Pjesëmarrje e stafit akademik në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, duke i dhënë mundësi të krijojë dhe zgjerojë rrjetin e bashkëpunimeve me aktorë vendas dhe të huaj;

b. Pika të dobëta:

1. Kategorizimi i lëndëve sipas veprimtarive në bazë të VKM nr.41 nuk është bërë duke marrë në konsideratë natyrën/përmbajtjen e lëndëve; (*Fusha II, Standardi II.1, Kriteri 1*)

2. UBT në bashkëpunim me Qendrën e Karrierës dhe Alumnit realizojnë gjurmimin e studentëve alumni në tregun e punës në nivel institucioni por nuk zhvillon analiza specifike për studentët e diplomuar në programin e studimit; (*Fusha V, Standardi V.6, Kriteri 4*)
3. Lidhur me sistemin e brendshëm të sigurimit të cilësisë:
 - Nuk ka ndarje të qartë të detyrave midis DVBSC, NJSBC dhe Komisionit të Përhershëm të Sigurimit të Cilësisë; (*Fusha VI, Standardi VI.1, Kriteri 2 Standardi VI.2, Kriteri 2*)
 - Instrumentat dhe mekanizmat e vlerësimit të brendshëm të cilësisë janë të kufizuar dhe nuk sigurojnë rezultate individuale për cilësinë e programit të studimit; (*Fusha VI, Standardi VI.3, Kriteri 4*)

Rekomandime

1. Institucioni duhet të rishikojë kuadrin rregullator në përputhje me organigramën e re dhe në ndonjë rast të eliminojë ndonjë mospërputhje midis rregulloreve;
2. Të bëhet rikategorizimi i lëndëve të planit mësimor sipas VKM nr. 41, në përputhje me përmbajtjen e tyre;
3. Të lehtësohet ngarkesa e personelit akademik, vecanërisht në drejtim të numrit të lëndëve/moduleve që japin mësim, me qëllim që të garantohet cilësia e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies;
4. Institucioni të rishikojë politikën e tij në mbështetje të kërkimit shkencor, në drejtim të rritjes së buxhetit në këtë drejtim;
5. Për të matur efektivitetin e diplomës në tregun e punës, institucioni duhet të ndërmarrë gjurmime specifike për studentët e diplomuar në programe të vecanta studimi;
6. GVJ rekomandon që të rishihen rregulloret e strukturave të NJSBC për një përcaktim më të qartë të detyrave dhe përgjegjësi të tyre. Institucioni të formalizojë dhe të zgjerojë instrumentet për sistemin e vlerësimit të brendshëm dhe rezultatet të përpunohen dhe nxirren për cdo program studimi;

Evaluation's conclusions for the second cycle study program

Professional Master "Finance and Banking"

a. Strengths and affirmations:


1. The study program is offered in accordance with the national development strategies and according to the purpose and the mission of the institution, as well as the legal provisions;
2. Contemporary curriculum in accordance with the standards and the objectives of the second cycle study program;
3. High level of research-scientific qualification and the commitment of the academic staff of the study program in terms of increasing the quality of teaching, improving the curricula and using innovative methods during the teaching activity;
4. Numerous cooperation agreements with business units, institutions of higher education and with other public and private institutions to realize the study objectives both in the learning process, research-scientific activity, as well as in the implementation of teaching practices;
5. Appropriate environments and modern didactic infrastructure available to the study program provide the necessary contemporary spaces and conditions for the learning process;
6. Use of contemporary literature, in accordance with the study program - physical libraries and on-line platforms;
7. Participation of the academic staff in national and international projects, giving them the opportunity to create and expand the network of collaborations with local and foreign actors;

c. Weaknesses:

1. The classification of subjects according to categories based on by CMD no. 41 does not take into consideration the nature/content of the subjects; (*Standard II.1, Criterion 1*)
2. UBT, in cooperation with the Career and Alumni Center, tracks alumni students in the labor market at the institution level, but does not develop specific analyzes for students who graduated from the specific study program; (*Standard V.6, Criterion 4*)
3. Regarding the internal quality assurance system:
 - There is no clear division of duties and responsibilities between DVBSB, NJSBC and the Permanent Quality Assurance Committee; (*Field VI, Standard VI.1, Criterion 2 Standard VI.2, Criterion 2*)
 - Internal quality assessment instruments and mechanisms are limited and do not provide results for the quality of the specific study program; (*Field VI, Standard VI.3, Criterion 4*)

Recommendation

1. The institution should review the regulatory framework in accordance with the new organizational chart and in any case eliminate any inconsistencies between the regulations;
2. The subjects classification according to VKM no. 41, should be reviewed taking into consideration the specific content of each subject/module;
3. The teaching load of the academic staff should be reduced, especially in terms of the number of subjects/modules they teach, in order to guarantee the quality of the teaching and learning process;
4. The institution should review its policies in support of scientific research, in terms of budget increase;
5. In order to measure the effectiveness of the study programme degree in the labor market, the institution should undertake tracking analysis for students who have been graduated in the specific study programs;
6. The regulations of the IUQA structures should be reviewed for a clearer definition of their duties and responsibilities. The institution should formalize and expand the instruments for the internal evaluation system and the results should be processed and released for each study program;



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Niveli i plotësisht	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X